



mehmet shpendi  
 “nder i i kombit”  
 në panteonin  
 historik



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 141, korrik 2015  
 Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Foto Luigj Shyti

## 2 JETA E MEHMET SHPENDI NË SHERBIMTË VENDI

## 3 MIRËSEARDHE MEHMET SHPENDI NË PATEONIN E MUNGUAR!

Pas një rrugënaje të gjatë njëqindvjeçare, patrioti Mehmet Shpendi kthehet në panteonin që i ka dhuruar historia. Një kthim i vonuar dhe i mirëpritur i kalorësit të pararojës së lëvizjeve të mëdha patriotike për pavarësimin e Shqipërisë. Një shekull më parë Kostandin Nikiç mendoj se me një batore vrau Leonidhën e Tërmapileve shqiptare së bashku homeriket e maleve tona. Vrasja e Mehmet Shpendit la pas një zbrazësi dhe varfërim të pa zëvendësueshëm. Djelmia humbi tribunin që mundi me i pri në ndeshjet e duhishme me dushmanët e vatanit.

## 4 100-vjetori i përbadhjes së madhe të popullit të Planit e të Dukagjinit kunder ushtrisë malazeze

## 6 MEHMET SHPENDI NË VENDIN E MERTUAR

## 9 CAMAJ, MËRGIMTARI QË E MORI ATDHEUN ME VETE

I detyruar të linte vendlindjen kur ishte vetëm 18 vjeç, shkrimtari i madh Martin Camaj e mori atdheun me vete në krijimtarinë e tij letrare, duke u qëndruar përjetë besnik alpeve. Sot bëhen 90 vjet nga lindja e shkrimtarit, akademikut e albanologut...

## 11 “Dita e Bjeshkës” në Theth

# JETA E MEHMET SHPENDIT NË SHËRBIMTË VËNDIT

## FJALA NË CEREMONINË E PËRURIMIT TË MONUMENTIT

I nderuar Sekretari i Përgjithshëm së Presidencës, zoti Florian Nuri!

I nderuar Z/Ministri i Mbrojtjes, zoti Petro Koçi!

I nderuar Z/Ministri i Kulturës, zoti Zef Çuni!

Të nderuar miq!

Të nderuar autoritetet vendore të Qarkut Shkodër!

Të nderuar pasardhës të atdhetarit Mehmet Shpendi!

Zonja e zotërinj!

100 vjet më pare u vra pabesisht, një nga burrat e mëdhenj të Dukagjinit, Mehmet Shpendi! Një luftën për jete a vdekje, me një ushtri të rregullt malazeze, u vranë 106 vete. Vetëm në hapësirën Plan-Gjuraj u vranë në përpjekje luftarake dhe pasi u kapen robër, 78 burra dhe tre gra. Dje, ketë ngjarje, e përkujtuam, në rajonin Qeresh, të fshatit Gjura, pikërisht në atë vend, ku 75 vjet më pare, me 15 korrik 1940, i gjithë para dhe famullitarë e Dukagjinit ngritën një kryq me përmasa 3 x 1.5 m, në kujtim të kësaj ngjarje historike, simbol i së cilës mbeti Mehmet Shpendi.

### KUSH ISHTE MEHMET SHPENDI?

Ai, lindi me 1851, në fshatin Pecaj, krahinë e Shalës, në një familje tipike brez pas brezi, si një nder familjet më patriotike e me tipologji malësore plot atdhedashuri. Mehmet Shpendi, u lind dhe u rrite në një mjedis atdhetar e luftarak deri ne legjenda, për hapësirat shqiptare. Dukagjini gjate gjithë historisë së tij ka qene aktiv sa here që e ka kërkuar nevoja e atdheut. Në ketë mjedis u mbrujtur midis legjendave e historisë u fisnikërua edhe shpirti heroik i Mehmet Shpendit

Në vitin 1890, themeloi organizatën "Djelmnia e Shalës" dhe jo pak e quajtnë "Bashkimi i djelmnise se Shalës"

Në vitin 1908, duke kundërshtuar hapet kërkesat e Xhon Turqve, në krye të me se dyqind vetave, prej të gjitha aneve të Malësisë, u nis për të nxjerr të burgosurit. Hapi burgun dhe nxori ç'fare kishte brenda. Valiu nuk e pa të udhës të kundërshtonte.

Me 7 korrik 1910, Mehmet Shpendi jep kushtimin në Dukagjin dhe në krye të kryengritësve zënë pozicionet në vijën: Qafe Valbone - Qafe Ndermajë - Qafe Agri dhe Qafe

Sterziqen, në një gjerësi fronti, rreth 10 deri 12 kilometra. Përballë kishte forcat e deri një Divizion të këmbësorisë malore, me rreth 9 batalione dhe 5 bateri të artilerisë malore. Luftimet ishin shume të ashpra ... Mbas luftimesh të ashpra e deri trup me trup, djelmnia e Dukagjinit e mundi Pashën (Tergut Pashën), e detyroi të kthehet mbrapsht, duke lenë shume të vrare, të plagosur e robër. Me 24 korrik u detyrua të tërhiqet e të kaloi në drejtimin Fierzë - Puke - Shkodër. Kënga thotë: '.... Tergut Pasha po çuditet / prej çudie mori frike / gurtë ju duken gjithë gjind pritet / kthen ushtrinë e u vu me ik ...'.

Mehmet Shpendi, në këtë lufte shpalosi aftësi të radha si prijës i afte e i urte, trim dhe i vendosur, organizator e drejtues i talentuar ushtarak "gjeneral" popullor. Ai thoshte: "Në dyert e Dukagjinit Terkut Pasha u mund. Atë e mundi djelmnia e Dukagjinit, e mundi populli i nënte flamurëve".

Për të mashtruar malësinë me lehte, xhonturqit përhapen fjalën: " .... Kush sundon kështjellën e Shkodrës, sundon Malësinë". Mehmet Shpendi përgjigjet: "... Shkodra ka vetëm një kështjellë ... në Malci çdo shkam asht ma i forte se kështjella. Shkrepat tona nuk kane të sosun. Pra, në çdo shkam e gur mund të luftohet dhe unë do ta pres turkun kudo me pushke".

Me të filluar veprimet kryengritëse, me 1911, Mehmet Shpendi hidhet menjëherë në ballin e luftës. Në fillim çeta e tij është e vogël, por shpejt u rrite me disa qindra djelmni.

Me 12 qershor 1911, në Greç Mehmet Shpendi së bashku me Dedë Gjon Lulin, i dërgojnë Ministrin të Punëve të Jashtme të Anglisë, Grej, një kujtese, në të cilin i përmendin kërkesat e paraqitura me 30 mars Fuqive të Mëdha.

Vitet 1910-1912 ishin vite të një lëvizje shume të fuqishme për pavarësinë e Shqipërisë. Në këto lëvizje, është i kudondodhuri Mehmet Shpendi, në krye të Djelmnise së Dukagjinit,

Me gjithë vështiruesit e panu-



mërta të luftëtarëve e familjeve të tyre e të tere popullit të Malësisë, nuk e mposhten Mehmet Shpendin me luftëtarët e tij. Ai, pa kaluar shume kohe e gjejmë përsëri në ballët e luftës për liri e pavarësi të atdheut.

Në vjeshtën e vitit 1911, nëpërmjet Gjelosh Rames në Curraj të Eper, Mehmet Shpendi lidhi miqësi me Bajram Currin. Besnik deri në fund i çështjes së luftës për çlirimin e atdheut, në valën e furishme të kryengritjes së vitit 1912, Mehmet Shpendi me shume shoke të djelmnise së Dukagjinit, luftoi krah për krah me trimat e Kosovës, nen prijën e Bajram Currin. Me forcat e pararojës së ushtrisë kryengritëse shqiptare që çliroi Shkupin, qene edhe disa luftëtare të djelmnise së Dukagjinit, me në krye Mehmet Shpendin.

### VITI 1915 QE I KOBSHËM PËR SHQIPËRINË E MEHMET SHPENDIN

Kishte filluar Lufta e Pare Botërore. Në qershor 1915 forcat e armatosura të Malit të Zi sulmuan Shkodren dhe gjithë Malësinë. Me 27 qershor pushtuan qytetin e Shkodres dhe rrethinat e saj. Pas kësaj date bene përpjekje te pushtonin malësinë e Shkodres. Me datën 4 - 5 korrik luftime të ashpra u zhvilluan në rajonin e Dakajve-Gimaj e Nënnavriq, ku u zunë rob forcat e deri një brigat këmbësorisë malore (rreth 1200 vete), të cilat me datën 5 korrik,

te Ura e Shalës u detyruan të kalojnë nen kulmin e dy armeve të vendosura kryq, u përcollën deri në Qafe të Pejës dhe u lanë të lire te shkonin në token e tyre me arme pa shula. Pas kësaj pritet ne bese dhe marrin peng Mehmet Shpendin, Çun Nika, Marash Deline dhe i riu Dede Lulashi. Ata, në realizim të qëllimeve të tyre për të nënshtruar Dukagjinin, dërgojnë forca të tjera ushtarake në drejtimin Gruemire - Plan - Shale (deri një brigat të këmbësorisë malore me komandant gjeneral Marian Pashen). Në rajonin Qafe e Mgulles - Gjura e Plan rezistenca ishte e madhe. Luftëtarët popullor e goditen kudo sa e

detyruan te rrethohet në rajonin Nderkiza të Planit (ku buron lumi i Kirit), të cilët vetëm tradhtia i shpëtoi nga asgjësimi, ose kapja rob e tyre.

Jeta e Mehmet Shpendit, prej 64 vjetësh, 42 vjet prej tyre, janë jete luftarake ne shërbim te vendit te tij dhe çështjes shqiptare për liri e pavarësi. Mehmet Shpendi ka qenë e vazhdon të mbetet simboli i qëndresës popullore të Dukagjinit në udhëkryqet më delikate të historisë sonë nacionale. Përfaqësuesi më tipik i vegjëlisë pa ndonjë pozite në hierarkinë e fisit, pa asnjë privilegj dhe funksion ushtarak, arriti të përjetësohet në ndërgjegjen tonë nacionale si prijës kreshnik i Dukagjinit, si kapedan i dëgjuar i betejave të stuhishme, si dije-tarë i kuvendit, si pleqnarë i se Drejtës Zakonore,, si një atdhetarë me ndërgjegje të lartë nacionale, si një figure komplekse me autoritet gjithëkombëtarë i flijuar për idealin më të shtrenjtë të një kombi. Ne fakt, Hero i pa diskutueshëm, por i pa kurorëzuar deri me sot.

Kush nuk shkroi për Mehmet Shpendin?! Nga Mbretëresha e Malësisë, Edit Durham, Dom Ndoc Nikaj. Baron Franc Nopça, Risto Siliqi, historiani Pal Doçi, Helmut Eberhart, Profesor Zekaria Rexha. Dom Gjeçaj, Akademiku Mark Krasniqi; "Hylli i Drites", viti 193 e 1937; Gazeta "Drita", Nr 7, Manastir 27 prill 1911; Gazeta e "Vërteta", nr. 8, Stamboll, 1911; Lasgush Por-

deci, Përparim Rexhepi, at'Benardin Palaj, at'Shtjefen Gjecovi; Luan Burrthyesi; Dode Kaçaj, Mhill Çuni e Lazer Kodra.

### LAVDI JETËS DHE VEPRIMTARISË LUFTARAKE TË MEHMET SHPENDIT!

Nuk është ndonjë vend tjetër në altarin e Heronjve, që ia kushtoi tere jetën atdheut e nacionalitetit shqiptar, si Mehmet Shpendi. Prandaj, Mehmet Shpendi nga Këshilli i rrethin Shkodër, me vendim nr. 129 date 3 /XI / 1969, është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Me dekret nr. 4617, date 09. 09. 2005, në kuadrin e 90 vjetorit të rënies së tij, Presidenti i Republikës i akordon "Medaljen e Arte të Shqiponjës". Por, nderi i këtij kolosi te atdhetarizmit, nuk mbyllet këtu. Kryesia e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", vendosi e mori nismën, që Mehmet Shpendi të përjetësohej dhe ku, në qytetin e Shkodrës, duke i ngritur një shtatore me këto përmasa që e kemi përpara dhe kjo u arrite, në saj dhe të mbështetjes ligjore të Kryetarit të Bashkise Shkodër, Lorenc Luka dhe këshillit të këtij qyteti, me në krye av. Bardhyl Lohja. Por, nuk mund të realizohej kjo nisme, pa mbështetjen financiare të 156 dukagjinas dhe jo dukagjinas që nga SHBA, Belgjika, Italia dhe në Shqipëri, në veçanti në Shkodër. Në mënyrë të veçante të dukagjinasve në Nju-Jork, të cilët siguruan 52 % të gjithë fondit të përgjithshëm për ndërtimin e të dy monumenteve, të atdhetarit Mehmet Shpendi dhe të albanologut Martin Camaj. Në mes nesh ndodhet Tome Balbona, kryetari i këtij komuniteti. Kurrë nuk do te harrohet kontributi tyre. Por, sot kemi dhe një surprize të veçante, që është në kompetencën e Presidentit të Republikës ta publikojë, Sekretarit të Përgjithshëm, zoti Florian Nuri, por kjo e veçante është arritur në saj të mbështetjes që na ka dhënë Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, Maxhid Cungu dhe Këshilltari diplomatik për rajonin, zoti Flamur Gashi.

Të gjithëve ju jemi mirënjohës! Ju faleminderit!

**NDUE SANAJ**  
Kr. i Shoq. "Atdhetare Dukagjini"  
Shkodër, me 16 korrik 2015

# MIRËSEARDHE MEHMET SHPENDI NË PATEONIN E MUNGUAR!

- EMOCIONE PËRPARA SHTATORES SË  
MEHMET SHPENDIT -

Pas një rrugënaje të gjatë njëqindvjeçare, patrioti Mehmet Shpendi kthehet në panteonin që i ka dhuruar historia. Një kthim i vonuar dhe i mirëpritur i kalorësit të pararojës së lëvizjeve të mëdha patriotike për pavarësimin e Shqipërisë. Një shekull më parë Kostandin Nikiq mendoi se me një batore vrau Leonidhën e Tërmapileve shqiptare së bashku homeriket e maleve tona. Vrasja e Mehmet Shpendit la pas një zbrazësi dhe varfërim të pa zëvendësueshëm. Djelmia humbi tribunin që mundi me i pri në ndeshjet e duhishme me dushmanët e vatanit.

Me kuje e zë funebere qau lahuta virane nga dhimbja se mos vdiq Ora e Maleve të Shqipërisë. Por harku dhe zharku ndërruan mendimin dëshpërues kur në jonet e tyre poetike ndien se kujtimi juaj ishte jashtëzakonisht i gjallë edhe pas vdekjes, një Kambanë e dobishme për zgjimin nga përgjumja të shqiptarëve në kohë më të vështira

Patrioti Mehmet Shpendi kthehet në panteonin e tij të munguar si një emër i përvetshëm që historia e ka për zemër. Një fatos personifikim i fisnikërisë, e njerëzisë bujare të gjakut tonë arbëror. Në 100 vjetorin e flijimit, vigani syshqiponjë e zemër çeliktë, rikthehet në memorialin e tij të bronzit të vlerësuar me kurorën e artë "Nderi Kombit". Mehmet Shpendi me gjakun e tij të kulluar martir u bë kumbara i vëllazërimit kombëtar i një plejade të vjetër që i hapi udhën lirisë dhe përgatiti 28 nëntorin fatlum të historisë. Apostulli i shqiptarizmit, Luigj Gurakuqi buzagaz krahehapur të uroi "Mirë se erdhe o krushkamadhi i lirisë! Mirë se erdhe o vëlla se më kishte djegur malli me të pa! Mirë se erdhe në Shkodrën tonë Iliriane, se cilës ju bere mburojë në kohet më vështira kur zbrapose pa lavdi Shefqet Turgut Pashën dhe Kostandin Nikiqin.

Oso Baroti (Kuka) nga çardaku i fortesës së tij të zjarrtë del e thërrret "Ardhsh i bardhë o Mehmet Shpendi, o flaka e zjarrit të lirisë!" Isa Baletini gjithë ngazëllim e hare fillon të bëjë hajgare me shokun armëve. Ku ishte bre o baca Mehmet?! Unë ka kohë që kam ardhur prej Bajgore, duke të pritur të vish në Shkodër. Kush ta preu rrugën o vëlla, që vonove kaq shumë me u ulë prej Shale!"

Mehmet Shpendi erdhi i derdhur në bronz, falë iniciativës së intelektualëve të Shoqatës "Atdhetare- Dukagjini" dhe zemrës bujare të banorëve të kësaj bashkësie. Përrurimi i monumenteve, të Mehmet Shpendit sot, dhe të Martin Camajt në muajin tetor, përbejnë dy ngjarjet më të rëndësishme të vitit 2015, në jetën kulturore të Shkodrës kulturëdashëse.

Ky masiv shkëmbi mbi të cilën lartësohet shtatorja e fatosit të bjeshkëve, simbolizon bazamentin mitologjike të një krahine kryelartë, ku kurrë as turku as shka nuk mundën dot të ngulin thundrat e tyre të çeliktë. Çakçirë bardhi Mehmet Shpendi lartësohet me profilin e tij epik, me një vështrim majtas nga Alpet barriera natyrore e pa mposhtur Shkodrës dhe me një vështrim djathtas nga kështjella e Rozafatit, emblema mitologjike këtij qyteti. Është një gjetje zgjuar kjo vendosje skulptorit Skender Kraja, sintezë e një proverbi të vjetër historik "Kush sundon kalanë e Shkodrës sundon edhe malësitë". Në këtë shesh Mehmet Shpendin, dolën për ta pritur atdhetarë tanë më me shenjë nder mote si Dasho Shkreli, Hodo Sokoli, Muharrem Kazazi, Hil Mosi, Risto Siliqi, Bajram Curri, Manush Alimani, Vasal Shanto Tomë Kola e të tjerë e të tjerë. Mungon vetëm flamurtari i Deçiqit, Dedë Gjon Luli, i cili ende nuk po gjen dot rrugën për në Shkodër. Në këtë shesh, Mehmet Shpendin dolën për ta pritur dhjetëra e dhjetëra qytetarë, intelektual, artist, te moshuar, të rinj e te reja, jo vetëm nga Shkodra, por edhe nga Tirana, Prishtina, Mali i zi e diaspora në Evropë e Amerikë. Mehmet Shpendin dolën për ta pritur drejtuesit me te lartë të pushtetit vendore dhe përfaqësuesit e Presidencës, dhe te Qeverisë. Mehmet Shpendi, u rrit, u burrërua dhe u plak në shërbim Shqipërisë. Mehmet Shpendin, nuk e ligështuan, as vendimet e Berlinit, as topat e Turgut Pashës, e kacaturrat e Veshoviqit. Mehmet Shpendin e shytoi plumbi i pushtuesit shovinist, por nuk e theu paraja, as ari i as një të huaji.

Mehmet Shpendi është një emër për bashkues, i cili shqiptarizmin e pati Zot e parti e fe!

Përgatiti  
PRELË MILANI

# MEHMET SHPENDI U NGJIT NË PIEDESTALIN QË MERITON

Qëkur kemi filluar të mbajmë mend, në bashkëvendlindasit e Mehmet Shpendit, sidomos shaljanët, kemi dëgjuar për këtë kreshnik nëpërmjet tregimeve gojore nga të parët tanë e deri nga këngët e djepit (u bësh trim si Mehmet Shpendi), si dhe ato të shoqëruara me lahutë dhe çifteli, që kishin për subjekt këtë prijës të madh popullor. Kur mësuam të lexojmë, kjo figure na del me tërë madhësinë e tij nëpërmjet librave që u shkruan për të, nga poetë të ndryshëm, Risto Siliqi në vitet e para të shekullit të njëzetë, më vonë Sterjo Spase në romanin "Ja vdekje, ja liri", në të cilin dy personazhet kryesor janë Dedë Gjon Luli e Mehmet Shpendi – udhëheqësit kryesorë të kryengritjeve 1910-1912 që sollën Pavarësinë e Shqipërisë. Nga tregimi gojore, këngët dhe librat mësuam se ky luftëtar i madh kishte një veprimtari shumë të gjerë në luftë me pushtuesit e ndryshëm turq, malazeze e të tjerë. Formoj dhe drejtoj të parin formacion luftarak me emrin "Djelmnia e Shalës", që ishte edhe e para opozitë shqiptare, e cila kundërshtonte çdo vendim që merrnin ata që paguheshin nga pushteti i kohës, të cilat binin ndesh me interesat e popullit të thjeshtë. Ishte udhëheqës popullor që nuk paguhej nga askush. Materialisht ishte më fukara se shumë bashkëlufetarë të tij.

Asnjë regjim nuk ja bëri vlerësimin që meritonte. Asnjëherë nuk ja dhanë titullin "Hero i popullit", sepse edhe Ai mbas vdekjes u bë viktimë e luftës së klasave, në një kohë kur hero u bënë edhe ata që nuk e kishin çerekun e veprimtarisë së tij. U deshtë të mbusheshin 100 vjet nga vrasja e tij, që Ai të merrte vlerësimin që meriton duke i dhënë titullin më të lartë "Nderi i kombit". Përkujtimi i njëqind vjetorit të qëndresës së popullit dukagjinas kundër pushtuesve malazez dhe vrasjes së 81 qëndresave më të mirë, me në krye Mehmet Shpendin, kryesisht nga Plan -Gjuraj, si dhe vendosja në piedestalin që meritonte Mehmet Shpendit, ishte evenimenti më kulmor që shoqata "Atdhetare- Dukagjini" ka organizuar ndonjëherë – frutë i përpjekjeve titanike të drejtuesve të saj, sidomos që me formimin e shoqatës.

Pata fatin të jem pjesëmarrës në dy ditët e këtyre veprimtarive, në Qeresh të Gjurajve dhe në qytetin e Shkodrës. Mbas një udhëtimi të gjatë e raskapitës nga rruga jashtë dorës së shtetit, në Qeresh të del përpara madhështor lapidari i rindërtuar shumë cilësisht me kontributet e shoqatës "Atdhetare Dukagjini" dhe të komunitetit Plan –Gjuraj, me në krye vëllëzërit Kodra. Ky lapidar, në të cilin janë shkruar edhe 81 emrat e të rënëve me 12-15 korrik 1915, i harmonizuar me atë natyrë të mrekullueshme të bëjnë që mos ta ndiesh lodhjen. U bëra edhe pak nostalgjik, sepse në memorien time u shfaqen tre vitet më të mira të rinisë që kalova në Plan -Gjuraj, që për mua ishin një universitet i dytë. U takova me ish nxënës e prind që kisha 41 vite pa i parë. Mu dukte koha shumë e shkurtër edhe pse Dielli të përvëlonte. Madhështia e natyrës u harmonizua me shpirtin e pastër të banorëve të atyre anëve, ku në asnjë veprimtari tjetër nuk ishin gërshetuar aq mirë të tre brezat, të cilët me bisedat, bujarinë, këngët e humorin bënë që mos të ndihet mungesa e pjesëmarrjes së pushtetarëve lokal apo qendror. E patëm të vështirë të largohemi prej andej falë bujarisë e mikpritjes së vendasve, të cilët nëpërmjet të palodhurit Sokol Kroni, na bënë që të kujtojmë me nostalgji ekskursionet e dikurshme. Gjallëri kësaj veprimtarie i dhanë këngëtarët e mirënjohur Fran Kodra, Ndue Shytani, Pllumb Vrinca dhe Kristian Zalli, të cilët bënë që koha të na iki shpejt dhe rrugës mos ta ndiejmë lodhjen.

Përkujtimi i ngjarjeve e figurave siç janë këto që po flasim, tregon respekt për të kaluarën dhe për të parët tanë duke hedhur kështu edhe themele të forta për të ardhmen, sepse kur din nga ke prejardhjen, din edhe ku shkon. Kjo në antipod me disa dukagjinas, të cilët jo vetëm nuk kanë asnjë lloj kontributi, por as nuk marrin pjesë në veprimtaritë e organizuara, flasin me një farë përqeshje për kontribuuesit, përpiqen vetëm të japin këshilla dhe ekstremizmi i tyre arrin deri aty sa bëjnë thirrje me e zhduk shoqatën. Fatmirësisht këta janë në minorancë dhe "lumi" i vrullshëm dukagjinas do t'i nxjerrin anash këto skorie.

Për mbi 40 vjet Mehmet Shpendi luftoi me armë në dorë në krye të luftëtarëve shaljanë që nga Podgorica deri në Shkup, deri sa dha edhe jetën. Ai dhe bashkëlufetarët e tij binin në Shkodër vetëm për të luftuar përkrah qytetarëve ose për të bërë treg sidomos për festa të ndryshme. Sot, pasardhësit e tyre janë vendosur në qytet e rreth tij, duke e braktisur vendlindjen e tyre siç e kishte parashikuar që herët pasardhësi i afërt i Mehmet Shpendit - i mënçuri Mark Sadiku. Sot edhe Mehmet Shpendi u vendos në qytetin e Shkodrës, "qytetari" më i ri i derdhur në bronz, një vlerë e shtuar për këtë qytet, të cilin e zbkuron krahas Nënë Terezës, Luigj Gurakuqit, Prek Calit, 5 heronjve të Vigut, Isa Boletinit, e të tjerë. Së shpejti këtyre ikonave të atdhetarisë do të ju bashkohet edhe dukagjinasi tjetër, i madhi i letrave, Martin Camaj – falë përpjekjeve të mëdha të shoqatës "Atdhetare Dukagjini", e cila po e justifikon emrin e madh që ka.

Me madhësinë e tij, Mehmet Shpendi të duket sikur iu drejtohet brezit të sotëm dukagjinas, sidomos të rinjve: "Mos na koritni! Mos u tërhiqni para vështirësive! Jetoni me djersën tuaj dhe shmanguni sa të mundeni plagëve dhe veseve të këqija, që kohët e reja na i kanë nxjerrë në skenë! Mbajeni kokën lart edhe në qoftë se ndonjë bashkëkohës i juaj bën ndonjë veprim që përpiket të dobësoj imazhin e mirë para skeptikëve, që nuk jua duan të mirën! Përpiquni, që këta keqbërës të jenë sa më të pakët! Meqenëse asnjë nuk jua zënë kryet për të parët tuaj, as ju mos bëni veprime që të i turpëroni ata! Bëni mirë që t'i gërshetoni vetitë e virtytet më të mira që keni marrë nga vendlindja, të cilat i qëndrojnë kohës, me edukatën qytetare që keni gjete në vendbanimet e reja. Atëherë do të bëheni qytetar të përkryer. Sidomos të rinjtë, ta duan shkollën, që nëpërmes një arsimit sa më cilësor, të pajisen me sa më shumë dije që të bëhen sa më të denjë për familjen e shoqërinë në mënyrë që vargu i gjatë i dukagjinasve, që kanë bërë emër të mirë në të gjitha fushat e jetës, të shtohet me element të rinjë, të cilët të jua ngrenë ende më lart emrin e mirë të Dukagjinit e Shkodrës. Sot nuk keni nevojë për luftë si në kohën tonë, por keni nevojë për mend që të integrohni sa më mirë në jetën e re. Mos i detyroni banorët që i keni gjetur aty, që të jua bëjnë me gisht për keq, por me sjelljet, veprimet e mosveprimet tuaja të fitoni respektin e tyre, sepse nuk ka rëndësi nga e ke prejardhjen, por sa vlera qytetare ke...".

Me vendosjen e përmendores së Mehmet Shpendit, qyteti i Shkodrës do të ketë një pikë orientuese më shumë. Nuk do t'i thonë më "te fermentimi", i cili nuk ekziston, por tek "Mehmet Shpendi". Edhe në të ardhmen, shoqata "Atdhetare Dukagjini", bashkësia dukagjinase, kudo që ndodhet dhe pushteti vendor e qendror, duhet t'i shkundin nga pluhuri i harresës edhe figura e personalitete të tjera dukagjinase, për të ju dhënë atyre meritat dhe vendin që iu takon.

Përgatiti, PRELË SHYTANI

# 100-vjetori i përbadhjes së madhe të popullit të Planit e të Dukagjinit kundër ushtrisë malazeze

Të nderuar pjesëmarrës e të ftuar!

Korriku I 1915, është korriku më I rende që njihen malet e Dukagjinit. Ne sot përkujtojmë 100-vjetorin e luftës e te qëndrese te popullit të Planit e të Dukagjinit kundër ushtrisë malazeze. Në harkun kohor 2-15 korrik, tre operacione ushtarake ndërmori ushtria malazeze për nënshkrimin e Dukagjinit dhe në të tre-ja ai dështoi. Data 12-15 korrik 1915 edhe sot mbas një shekulli vijën të freskëta, sa të dhimbshme aq edhe të lavdishme në zemrat tona. Në qershorin e 1915 Krajl Nikolla (Petrovici) do deklaronte "Po nuk mora Shkodrën me Malësitë e saj, unë do te largohem nga Mali I Zi! Ai, synonte që përfundimi I Luftës së Pare Botërore ta gjente me Shkodrën e pushtuar për ta pasur me te lehte aneksimin e saj. Dukagjini, në përballjet me pushtuesit e huaj ka bashkërenduar e bashkëvepruar në mbrojtjen e hapësirave të veta. Kjo e ka bere Dukagjinin një kocke të forte, kështjelle të pamposhtur në Malet tona. At Gjergj Fish-ta ka shkruar ' Shume pushtues të huaj kane msy e kane kalue në malet e Dukagjinit, por kane ikur pa mundur me i sundue, ata kurrë nuk munden me i nënshtruar as me i zotnue. Ata kane kalue si uji mbi shpinën e rosës".

Dukagjini e ka mbajtur të gjalle, Besa. Armiqtë janë munduar ta shfrytëzojnë Besën e tij, me dredhite e tyre. Kështu ndodhi edhe në vitin 1915, me Krajlin e Malit te Zi, Petrovicin. Besimi në të pabesin dhe pabesia e të pabesit bën që Dukagjini të humbiste faktorin tone, duke pamundësuar organizimin e bashkëveprimit mbare krahinor, për të mundësuar dështimin e operacioneve pushtuese të ushtrisë malazeze, ashtu siç kishte ndodhur edhe në raste të tjera si në qafen e Agrit kundër pashait turk.

Mosqenia e Mehmet Shpendit në krye të forcave mbare dukagjinase, shkuarja e tij në Cetine për bisedime me Petrovicin, pati

ndikimin e vet në mos organizimin e mbrojtjes mbare krahinore. Në këto kushte fati i takoi populli te Planit të ishte në vijën e pare të përballjes me ushtrinë malazeze duke mbajtur peshën kryesore të luftës dhe të qëndresës. Situata në katër fshatrat e Planit u be e rende. Populli I Planit me luftëtarët e tij mundi të organizohej e të përballej me një ushtri të përgatitur e të armatosur dhe në numër më shume se vete numri I popullsisë, duke pasur lajtmotivin e vetëm, të pengoje e të dëmtoje sa të ishte e mundur ushtrinë malazeze në të gjithë hapësirën e Planit, me grupe luftëtaresh të përqendruar në qafa, kodra e lartësi nga mund të priste armikun, duke qene i ndërgjegjshëm dhe i vendosur edhe për pasojat që vinin nga kjo përballje e qëndrese.

Kush me mire se vargjet popullore e përkruajnë situatën "Janë mbledhë burrat e kan ba be / në kushtrim e bese me dek ku kena le / kush asht burr me lujt gishtin, ne çdo qaf e koder luften ta nisim / ..."

Për këto momente At Daniel Gjecaj do shkruante "Qafat u kthyen në prita e pritat në kala varrmihëse për ushtaret e Krnjazit". Ushtria malazeze nga populli dhe luftëtarët e Planit merrte lëksionin, me ngadalë o Krajl Nikolla, nuk i nxijmë kësulata tona, nuk ta lëshojmë token e të pareve, pse të shkojnë lum gjaku, stomit të arave. Qëndresa e popullit dhe e

luftëtareve të Planit ishte e madhe. Katër dite rresht shkruante At Danieli, në hapësirën e Planit, nata u ba dite nga mitralozat e fishekët e dinamitit, e dita u ba nate, nga tymi I topa e kullave të djegura.

Në Plan Veshovici, po shihte dështimin e tij për nënshkrimin e Dukagjinit, duke u detyruar të heqë dore nga vazhdimi i mëtejshme i operacioneve ushtarake. Situata, në katër fshatrat e Planit, At Justin Rrota e përshkruan 'Ndizet një luftim i mnershem. Malësoret bajne namin mbi ushtaret e Malit të Zi. Nji përballje e qëndrese heroike e luftëtareve dhe popullit të Planit. Për tre dite rresht në katundet e Planit nuk u pa gjë tjetër veç lufte, qëndrese, tym dhe flake. Nuk mbeti kulle as stan pa u djegur. Plani kishte marre pamjen e nji gërmadhe".

Pasha që mbajti populli i planit në ketë lufte qëndrese e përballje ishte e rende, por e lavdishme. Me 75 bije të tij të vrare në moshën më të mire, nga 20-50 vjeç. 300 kulla e 500 stane bagëtish te djegura, 5 000 koke bagëtish u morën dhe u theren nga ushtaret malazez, pyjeve për rreth Planit dhe çdo gjeje iu vu flaka, çdo gjë u be shkumb e hi. Në Plan u vranë edhe 3 pengjet, krrerë të Shalës, Mehmet Shpendi, Marash Delia e Çun Nika, si dhe Nik Çuni, flamurtari I Xhanit. Në një lufte heroike dhe te lavdishme u vranë edhe luftëtarët, Mark Sadria nga Toplana dhe Mark Preka nga Mirdita. Në të gjithë hapësirën e

Planit, nuk mund të thuhet apo të veçohet se këtu apo aty, qëndresa, lufta, trimëria dhe guximi i luftëtareve dhe popullit të Planit ishte me i madh. Jeta dhe gjaku nuk përfilleshin, heroizmi popullor ishte në shkallen më të larte dhe të lavdishme, jo vetëm për mbrojtjen e Planit, por edhe të Dukagjinit. Populli thotë edhe sot, po të shtrydhet kjo toke, kullon gjak. Në Plan u dëmtua edhe ushtria malazeze, me dhjetëra të vrare e me qindra të plagosur.

Në Plan dështoi ushtria malazeze për nënshkrimin e Dukagjinit, ajo ra moralisht dhe në një panik të madh. Veshovici gjeti rrugën e shpëtimit, por edhe të dështimit, largimin nga Dukagjini andej nga kishte ardhur, nga qafa e Beshkasis, me pjesën më të madhe të ushtrisë, brigada e gjeneral Mil Spasit u përqendrua në qafen e Boshit, për t'u larguar në një kohe tjetër sa më të shkurtër. Plani u be simboli i luftës dhe i qëndresës për dështimin e operacioneve të ushtrisë malazeze për nënshkrimin e Dukagjinit, në korrikun e 1915. Në nderim të banoreve të Planit, për luftën dhe qëndresën ndaj ushtrisë malazeze, në vitin 1940, në kuvendin mbare dukagjinase, 15 korrik, u vendos të përkujtohet në Plan, në Qeresh, këtu ku jemi ne sot. Një vendim i duhur, dinjitoz që dine ta bëjnë vetëm dukagjinasi, që nga ky vit e në vijim, 15 korriku I 1915, jeta dhe gjaku i 81 dëshmoreve të rene, përkujtohet me nderime dhe respekt nga mbare populli I Dukagjinit.

Lavdi 81 dëshmoreve, të rene kundër ushtrisë malazeze, në Plan, nderim Dukagjinit dhe Planit.

Ju faleminderit!

**Mhill Pali,**  
Kryetar i shoqatës "Spani"  
15 korrik 2015

## NË PËRVJETORIN I PËRBBALLJES SË MADHE TË DUKAGJINIT, NË PLAN DHE RËNIES SË MEHMET SHPENDIT "NDERI I KOMBIT

Bashkëbisedim, me Ndue Sanaj, Kryetar i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"

Shoqata, që ju drejtoni ka zhvilluar shume veprimtari në plotësimin e misionit dhe funksionit të saj, në Shkodër, jo vetëm aty, por dhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Në ketë bisede me ju duam të ndalemi veçmas tek veprimtaritë tuaja më të fundit, të vitit 2015, kryesisht te ajo e quajtura "Përballja e madhe e Dukagjinit, ne Plan", që kulmon dhe me një shtatore të Mehmet Shpendit të vendosur në qytetin e Shkodrës.

**Si i planifikuat e u zhvilluan këto veprimtari, pjesëmarrësit dhe mbështetësit deri në çastin e përrimitit të shtatores. Ndonjë gjë emocionale nga gjithë kjo ndërmarrje?**

I nderuar Gjon, faleminderit që me jep mundësinë të publikoj disa mendime rreth pyetjes suaj.

Shoqata e jone, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" e themeluar me 13 maj 2003, me moton "Mos pyet se çfarë beri, ose bën Dukagjini për mua, por pyet se, çfarë bej unë për Dukagjinin", vijojte të punojte për realizimin e misionit të saj, sepse në Dukagjin e te dukagjinasi ka mjaft brumë, por që duhet me pas kujdes në përpunimin e tij dhe mendoj se shpreh dhe mendimin e anëtarëve të kryesisë dhe të anëtarësisë së shoqatës, se deri tani e

kemi punuar mire; ky emision ishte mjaft fisnik, sepse kurrë dukagjinasi nuk i ka munguar fisnikëria; kurrë në Dukagjin nuk ka munguar puna e përbashkët, prandaj dhe anëtarët e shoqatës dhe në veçanti anëtarët e kryesisë punuan me përkushtimin më të madh vullnetar, që Dukagjini e dukagjinasi të paraqiten ashtu siç janë, me plot vlera atdhetare e kulturore në gjithë jetën e tij, në gjithë jetën e tyre; me plote virtyte, të cilat paraqiten me krenarinë më të madhe në prezantimin e vetes dhe që mund të jene në duet me bashkësitë ku ata banojnë e jetojnë, ku ata kane ngritur çerdhen e tyre të jetesës. Pra, kjo që realizua nuk ishte rastësi, por rrjedhoje e asaj historie brilante e Dukagjinit dhe e punës sonë prej 12 vjetësh, me shume përkushtim për Dukagjinin e dukagjinasi, sepse **Misioni** i shoqatës ishte dhe është shume i qarte për këdo, për anëtarët e shoqatës dhe në veçanti për anëtarët e kryesisë së saj. Ai ishte dhe është: "Duke u mbështetur në historinë e së kaluarës, duke respektuar ndjenjat dhe sakrificat e të pareve për liri e pavarësi, Dukagjini të zëre më mire vendin që meriton në Boten e qytetëruar e modern"

Pra, edhe propozimet e anëtarëve të kryesisë nuk dolën nga shterpësia, por nga një baze objektive e mbështetur në realizimet e Shoqatës të deri tanishme.

Në vjeshtën e vitit 2013, Sekretari I Shoqatës, Luigj Shyti, në një mbledhje kryesie, në mes të tjerave tha: " ... Në vitin 2015, kemi 100 vjetorin e rënies se Mehmet Shpendit, e lidhur me 100 vjetorin e Përballjes së Madhe të Dukagjinit, në Plan ... dhe duhet te bëjmë përpjekje të ngremë shtatoren e tij, në qytetin e Shkodrës". Në të njëjtën mbledhje, kryetari i seksionit të veprimtarive të shoqes, Prele Milani, në mes të tjerave tha: "... Në vitin 2015 kemi edhe 90 vjetorin e lindjes se Martin Camaj ..., mendoj që të mos i ndajmë këta dy kolos të Dukagjinit, pavarësisht nga jeta e tyre në kohe të ndryshme dhe për veprimtari të ndryshme ... edhe Martin Camajt, të bëjmë përpjekje t'i ngremë një shtatore në qytetin e Shkodrës ...". Ndoshta kushdo, jashtë jetës veprimtare të kryesisë së shoqatës, mund të habitej dhe në fakt janë habitur! Ndërsa anëtarët e kryesisë, jo që nuk u habiten nga këto dy propozime, por menjëherë i miratuan, ju futen punës, për të bere realitet propozimin e këtyre dy anëtarëve të kryesisë, sepse nuk mbeten më propozim i dy anëtarëve të kryesisë, por ato u bën pjese e kryesisë. Asnjëri në kryesi, nuk ju tha, a jeni në vete, si do të sigurojmë ketë apo atë gjë, sepse secili ishte i bindur që propozimi I tyre ishte I drejte dhe që duhej future punës për të bere gjithçka të mundur, për t'ia arritur

qëllimit. Pra, dëshira nuk mund të mungonte, mundësia për tu ndeshur me sfida të jetës së shoqatës nuk na mungonte dhe duke u bashkuar dëshira me forcën realizuese ju futem punës dhe tani jemi para një fakti të kryer. Mehmet Shpendi u ringjall pas 100 vjetëve dhe u vendos në qytetin e Shkodrës, me një madhësi 3. 7 metra, me gjithë bazamentin, te cilin e përruam me datën 16 korrik 2015 dhe Presidenti I Republikës e dekoroi me urdhrin e larte "Nderi Kombit" ...

Emocionet ishin të shumta e të mëdha. Mehmet Shpendi ka qene dhe mbetet idhulli im për atdhetarizëm, që kur isha në bankat e shkollës ushtarake "Skënderbej"! Pse? Mehmet Shpendi është i vetmi atdhetar dukagjinasi, që në 64 vjet jete, 42 vjet i kaloi me arme në dore për liri dhe pavarësi, pa u përkulur përpara asnjë shantazhi, asnjë privilegji, që u munduan nëpërmjet ndonjë vendasi çdo pushtues ta bënte për vete. Ne vitin 1995 e pata filluar punën për nderimin e jetës dhe veprën atdhetare të Mehmet Shpendit. Në vitin 2005, në kuadrin 90 vjetorit të rënies së tij, u nderua me "Medaljen e Arte të Shqiponjës". Dhe në kuadrin e 100 vjetorit të rënies së tij, u arrit të nderohet me urdhrin e larte "Nderi i Kombit". Lot gëzimi na kane shkuar kur u informuam se Presidenti i Republikës e ka firmos urdhrin e larte "Nderi i Kombit", për Mehmet Shpendin, pas vdekjes. Mehmet Shpendi u ringjalle pas 100 vjetëve dhe u vu ne rresht me figurat e larta të nacionalitetit tone! Nuk ka emocion, nuk ka gëzim më të madh, që atë, të cilin e ke idhull, arin ta ringjallesh në qytetin tënd, në qytetin e Shkodrës, duke e ngritur në një shtatore

në bronz, me lartësi 2.5 metra, në hyrje të këtij qytetit ... dhe e kompozuar nga mjeshtri Skënder Kraja dhe e derdhur në bronz, po nga një mjeshtër tjetër, Ramazan Karaj ...

Në momentin e zbulimit të shtatorës, nga Sekretari i Përgjithshëm të Presidencës, Florian Nuri, këshillari diplomatik për rajonin, Flamur Gashi, vajza e nipit të Mehmet Shpendi, Prenda Mark Shpendi në moshën 86 vjeçe, Luigj Shyti, Lorenc Luka, (kryetari i Bashkisë së qytetit Shkodër), Gjergji e të tjerë ishte diçka e veçantë ... Sikur Mehmet Shpendi na thotë: "A jini burra e gra!?" ... "Mire se ju ka pru Zoti në këtë oborr ..." ... shpërthyen duartrokitjet e fuqishme e të ligjshme për gjithë banoret e Dukagjinit, të Shkodrës e mbare shqiptare, sepse nuk u nderua vetëm Mehmet Shpendi, por e gjithë historia shkuarje të Dukagjinit, e dukagjinase ... Vërtetë shumë emocione, por unë e kam të vështirë ti përshkruaj ato, më shumë se kaq. Por dua të shtoj se, kjo arritje pa ndihmën e Kryetarit të Bashkisë së qytetit Shkodër, Lorenc Luka; kryetarit të këshillit të bashkisë së qytetit Shkodër, av. Bardhyl Lohja dhe Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, Maxhid Cungu, të cilët jo vetëm që na mbështetën, por na hapen rrugën ligjore, do të ishte e pa mundur të arrihej ky sukses. Me këtë rast, nëpërmjet këtij bashkëbisedimi i përshëndes në emër të Shoqatës dhe ju jemi shumë mirënjohës! Po, ne nuk mund të ecim pa mbështetjen morale dhe monetare të 157 kontribuuesve dukagjinase ane e mbanë botes, që nga Miçigani, Nju-Jorku, Belgjika, Italia, Tirana, Shkodra, në krye të cilëve qëndron bashkësia dukagjinase në Nju-Jork, me në krye Tome Balbona, e cila ka siguruar 52 % të gjithë fondit. Mirënjohje dhe i uroj me shprehjen popullore "Paçin e dhëncin!"

Është shkruar shumë pak, është e nevojshme të **mund të thoni diçka për atë që ju e keni quajtur "Përballja e Madhe e Dukagjinit, në Plan" dhe Mehmet Shpendin – Udhëheqësin e Djelmnise Shalës?!**

I nderuar Gjon, për këtë përballje nuk është shkruar pak, por është e vërtetë, se për këtë ngjarje kane shkruar të tjerët më shumë se ne, si shtypi i kohës, në veçanti gazeta "Shqiptare", "Kombi", At' Justin Rrota, At' Danile Gjeçi e të tjerë. Ai, që ka grumbulluar material, ka hulumtuar, ka studiuar dhe ka bere një shkrim më të plote për këtë ngjarje, në Plan, është Nënkolonel Mhill Pali, në pension, i cili në vitin 2006 ka nxjerrë një libër, me titull "Përballja e Madhe e Planit", dhe që meriton falënderimet e të gjithëve. Edhe unë kam mbajtur një ligjëratë, për këtë ngjarje, me teme "Qëndresa dukagjinase kundër ndërhyrjes ushtarake malazeze, korrik 1915" dhe është botuar në li-

brin e Shoqatës "Dukagjini në rrjedhat e historisë-1". Është shkruar edhe në gazetën "Dukagjini". Madje një shkrim të timin e te Fran Kodres e kemi edhe në librin "Dukagjini, Shqipëria ime aty". Pra, është shkruar, por jam me ty se, përderisa ende nuk kemi hy ne arkivin e Malit të Zi, për këtë ngjarje, nuk mund të pretendojmë se kemi thënë atë që mund të jete e vërteta. E vërteta, mund të dali e plote kur të kemi të dy anët. Atehere do të jemi më të qarte për ngjarjen dhe mund të shkruajmë më me saktësi rrjedhjen

Gropa të Strelit, në Pla' të Madh, Mbigure, në qafe Kuje e deri në Nderkiza të Planit, pra, në hapësirën e fshatit Plan-Gjuraj, derdhen gjakun 81 vete, në mes tyre tre gra dhe këta janë të shkruar në pllakën e këtij lapidari, që kemi përpara.

Ne, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" dhe Shoqata Patriotike Kulturore "Spani", në këtë 100 vjetor bëmë përpjekje të rindërtojmë lapidarin se, ai ekzistuesi i ndërtuar që në vitin 1970, ishte dëmtuar rëndë nga koha. Tani, jemi përpara këtij lapidari, që shikoni sot, pranë

se ende është aktuale, pavarësisht mendimeve globale, me të cilin duhet të bëjmë përpjekje në edukimin e brezave me këtë ndjenje, jo vetëm ne si shoqate, por të behet përpjekje në familje, të bëhen përpjekje në bashkësi, të bëhen përpjekje në shkollë, në punë e kudo ...

Për jetën e veprën e Mehmet Shpendit, tani "Nderi i Kombit", kane shkruar plote, të huaj e të vendit, që nga Mbretëresha e Malësisë, Edit Durham, Dom Ndoc Nikaj. Baron Franc Nopça, Risto Siliqi, historiani Pal Doçi, Helmut Eberhart, Profesor Zekaria Rexha. Dom Daniel Gjeçaj, Akademiku Mark Krasniqi; "Hylli i Drites", viti 193 e 1937; Gazeta "Drita", Nr 7, Manastir 27 prill 1911; Gazeta e "Vërteta", nr. 8, Stamboll, 1911; Lasgush Poradeci, Përparim Rexhepi, at' Bernardin Palaj, at' Shtjefen Gjeçovi; Luan Burrthyesi; Dode Kaçaj, Mhill Çuni e Lazer Kodra. Madje poeti Lasgush Poradeci i thurte keto vargje: "**Në Qafë të agrit iku si horr / Bedri pashaj vraponte / E pret në ballë një malsor / Që shtiu e po këndonte / Me faj e turp Sulltan -baba / Po kthehëm i ngarkuar / Se Mehmet Shpëni ish katalla / S'do mbret për ta sunduar**"

Mendoj se cilësimi i Mehmet Shpendit si kryetar i Djelmnise së Shalës, ja kufizon veprimtarinë e tij atdhetare. Si kryetar i këtij institucioni ishte njëra nga veprimtaritë e tij udhëheqëse. Ai ishte udhëheqës në gjithë jetën e tij atdhetare për liri e pavarësi i dukagjinase. Jo rastësisht i kane vu emrin "gjenerali popullor!". E cilësoj këtë se, jo në pak raste veprimtaria

e tij atdhetare kufizohet në drejtimin e djelmnise së Shalës, çka e cunگون jetën e veprën e tij atdhetare. Gjithashtu e theksoj këtë se, ka zëra të tilla nënvleftësues të jetës e veprës atdhetare të këtij Vigani të përmasave të jashtëzakonshme. Kurrë se ka pare Mehmet Shpendin, poeti Lasgush Poradeci, por kur është njohur me Luftën e Qafës së Agrit, është çuditur, se si është e mundur të thuhet një nga pashallarët më të fuqishëm të Turqisë së asaj kohe, në malet e Dukagjinit, në Alpet tona, në Alpet Shqiptare, nga djelmnia e Dukagjinit, të udhëhequr nga një prijës popullor, siç ishte Mehmet Shpendi, prandaj i thur vargun "**...Se Mehmet Shpëni ish katalla / S'do mbret për ta sunduar**". Këta, që mundohen të ulin rolin e Mehmet Shpendit në jetën atdhetare të dukagjinase, në veçanti për liri e pavarësi, në vitet kulmore 1910-1912, atij vigani asnjë gërvishje nuk mund ti behet, por për vete ata ç' burrërohen dhe bëhen mjerane, që askush nuk mund ti ngrejë nga batakun ku kane rene ...

Mehmet Shpendi ka qene dhe do te mbetet në jete të jetëve, brez pas brezi burim frymëzimi për atdhetarizëm! Lavdi jetës dhe veprës së tij dhe të 106 të rënëve në luftë me ushtrinë e Malit të Zi, 100 vjet

më pare, në muajin korrik 1015!

**Cilat janë disa nga veprimtaritë e planifikuara në këtë vit apo dhe ato afatshkurtra, që ju po punoni për ti realizuar?!**

Kryesia e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" që në muajin dhjetor të vitit kaluar, ka miratuar në Këshillin e Shoqatës planin e veprimtarive për vitin 2015, mbi bazën e së cilës punon gjate gjithë vitit. Në fokusin kryesor të këtij Planit kane qene dhe janë këto veprimtari:

Puna organizative për marrjen e masave për të siguruar gjithçka në ngritjen e dy monumenteve, atë të luftëtarit Mehmet Shpendi-Nderi i Kombit, të cilin e realizuam me sukses, me 16 korrik 2015 dhe të albanologut Martin Camaj, te dy bije të Dukagjinit. Njeri nga monumentet tashme i vendosur në vendin e përshkëm. Tani, jemi përqendruar tek puna për ngritjen e monumentit të Martin Camaj. Në fund të muajit korrik fillon të derdhet në allçi dhe në dhjetëditëshin e pare të muajit gusht dërgohet në Tirane, per t'u derdhur në bronz. Vijon punën e njëjti mjeshtër, skulptori Skënder Kraja. Monumenti i Martin Camaj do të përurohet me fillimin e vitet akademik 2015-2016 dhe do të vendoset pranë Bibliotekës së Universitetit "Luigj Gurakuqi". Në kuadrin e 90 vjetorit të lindjes së tij, në bashkëpunim me Senatin Demokratik, në Shkodër do të organizohet e zhvillohet një konference shkencore për Martin Camajn. Pasqyrimi i veprimtarive tona behet kryesisht në të përmuajshmen, gazetën tone "Dukagjini, e cila është pjese e pandare e shoqatës, do vazhdoje te jete një zë i fuqishëm.

**Diçka tjetër, në mbyllje të kësaj bisede, ndërkohë që ju shoh se, keni për të thënë shumë gjëra!**

Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" ka punuar për Dukagjinin e dukagjinasi kudo që ndodhen. Ne, punojmë për Shkodrën e shkodranet, për nacionalitetin tone kudo qe ndodhemi. Ne, jemi pjese e hapësirës gjeografike shqiptare, flasim shqip dhe kemi dhënë atë kontribut modest si çdo krahine tjetër e Shqiptarisë. Ne, në qofte se bëjmë përpjekje për të "hipur në qiell", se në fakt nuk mund të jemi, nuk do të merret kush me ne, sepse të tjerët ecin për toke. Prandaj, ju bej thirrje dukagjinase e dukagjinaseve, të ofrohen në Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini", veçanërisht të rinjve e të rejave, të bëhen pjese e saj se, do të gjejnë vetveten dhe të japin kontributin e tyre në ecjen përpara në fushën e mirëqenies, të kulturës dhe të been pjese e vlerave të një shoqërie të hapur, pjese e së cilës jemi edhe ne, në themel së cilës janë vlerat e individit. Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" do ta vijojë punën e saj me këtë pikësynime, me këtë moto siç e kemi filluar, pa u ndalur në realizimin e misionit të saj.

**Ju faleminderit dhe suksese në punën dhe misionin tuaj!**

**Bashkëbisedoj, Gjon Fierza**



e tyre, sepse sa do të jene të vërteta të dhënat e mbledhura në popull, '... kështu më ka thënë gjyshi apo kështu me ka thënë gjyshja, ...', nuk kane baze plotësisht shkencore. Besojmë se një dite do ja arrijmë të marrim të dhëna nga arkivi në Mal të Zi, për këtë ngjarje dhe të shkruajmë më me saktësi ...

Por, edhe në këtë 100 vjetor, në 100 vjetorin e Përballjes së Madhe të Dukagjinit, në Plan, u be diçka. U rindërtua Lapidari, u vu pllaka e re me shkrimin e 81 emrave të rene në këtë përballje në Plan. Hapjen e bëra unë dhe u ndala me këtë rast: "... Jemi bashkuar në këtë qafe, që quhet qafa e Qereshit, për të përkujtuar ata, të paret tanë, që 100 vjet më pare derdhen gjakun e tyre për të qene të lire dhe të pavarur, në lufte me një ushtri të rregullt malazeze, në muajin korrik 1915.

Kishte filluar Lufta e Pare Botërore. Me 27 qershor, pasi ushtria e Malit të Zi, kishte pushtuar gjithë malësinë e Mbishkodrës, u fut në qytetin Shkodër, pa shkrept asnjë pushke. Në hapësirën prej 12-13 ditëve lufte, derdhen gjakun e tyre 106 vete, në Dukagjin dhe prej tyre, në këtë hapësirë, që shohim ne, nga qafa e Mguilles, në gryke Thane, në qafe të Qytezës, në

të cilin vumë kurora dhe lule ..."

Për rindërtimin e lapidarit Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", ka mbuluar 2/3 e shpenzimit dhe me të drejte, në bazamentin e këtij Lapidari është vene një pllake, me shkrimin "Nga Shoqata Atdhetare-Dukagjini"

Por, megjithëse pati pjesëmarrje, pati disa mendia, që nga TV Shqiptar në Miçigan, me pronar Ndue Ftoni, por jo aq sa pritesh. Dhe kjo na ven përpara përgjegjësisë, që rinia duhet ta ndjeje më shumë çështjen atdhetare, se siç theksonte dikur Gjenerali i Famshëm i Oqeanisë, në Luftën e Dyte Botërore, Mac Artur: "**Të mos nënshtrohemi nga zërat e çuditshëm që dëgjojen lart e poshtë për të zhvlerësuar konceptin e vjetër të patriotizmit, i cili ka qene prej kohesh fortësia kryesore e integritetit tone kombëtar; mëmëritjet e disave se ai, Patriotizmi, sot është jashtë mode, se ne qe idealizojmë kombin qenkemi provincial, të pa pjekur ose konservator, budallenj ... Mos dëgjoni këto zëra ... Të jemi krenar të quhemi Patriot, Nacionalist, apo quajeni si të doni, nëse kjo do të thotë se do vendin tënd mbi gjithçka, do ta vini jetën tuaj po të jete e nevojshme, në shërbim të flamurit tuaj ...**". Kjo, thënie e këtij gjenerali, koha po vërteton

# MEHMET SHPENDI NË VENDIN E MERTUAR

Me datën 16 korrik 2015, ishte një dite e veçante, jashtëzakonisht e veçante. Shume kohe më pare, nuk mendohej se në qytetin e Shkodrës do të ngrihej e vendosej një monument, të njërit prej figurave më të nderuara, më të ndritura të fund shekullit XIX dhe të fillim shekullit XX, jo vetëm të Dukagjinit, por edhe i gjithë nacionalitetin shqiptar, siç ishte figura e "gjeneralit popullor", të atdhetarit Mehmet Shpendit.

Po ja, ne orën 10.00 te kësaj date, dite e enjte, filloi ceremonia e përvitimit të kësaj shtatoreje! Dhe jo vetëm kaq, por edhe dhënia e urdhrit "Nderi i Kombit".

Ne këtë ceremoni morën pjesë anëtar të shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", dukagjinase, shkodrane e tiranas. E nderuan këtë ceremoni miq nga Mirdita, nga Malësia e Madhe, nga Nikaj-Merturi; miq nga Kosova, te Shoqatës së vëlazërisë Kosove-Malësi e Madhe, me krye kryetarin e saj, Ukshin Jashari; nga Malësia e jone ne Mal te Zi, si te shoqatës "Dede Gjon Luli" e te tjerë. Ne mënyrë te veçante kjo ceremoni u nderua nga Sekretari i Përgjithshëm te Presidencës, Fation Nuri, këshilltari diplomatik i Presidentit, Flamur Gashi e te tjerë këshilltare te Presidentit; Z/ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi; Z/ministri i Kulturës, Zef Çuni; Kryetari i Bashkise se qytetit Shkodre, Lorenc Luka; Kryetari i Këshillit te Bashkise se qytetit Shkodër, av. Bardhyl Lohja; Kryetari i Këshillit te Qarkut Shkodër, Maxhid Cungu; Skulptori Skënder Kraja e shume personalitete te tjera te qytetit e me gjere.

Pas himnit te Flamurit, fjalën e hapjes se kësaj ceremonie e mori Sekretari i Shoqatës, Luigj Shyti, i cili pasi ju uroj mirëseardhjen te gjithë pjesëmarrëseve, i dha fjalën Kryetarit te Shoqatës, Ndue Sanaj, për te folur për jetën dhe veprën e Mehmet Shpendit.

Ne mes te entuziazmit te madh, fjalën e mori Tome Balbona, kryetari i bashkise dukagjinase ne Nju-Jork, i cili përshëndeti ne emër te kontribuuesve për realizimin e kësaj vepre ...

Mjaft emocionuese ishte momenti i zbulimit te Monumentit te Mehmet Shpendi, ne te cilin morën pjesë: Ndue Sanaj, Gjergj Leqejza, Luigj Shyti, Florian Nuri, Flamur Gashi, Lorenc Luka, te afërmit e Mehmet Shpendit, ne veçanti vajza e nipit te Mehmetit, zonja Prenda Mark Shpendi, ne moshën 85 vjeçe, Tome Balbona e te tjerë ... Lot gëzimi, qe me ne fund ku vigan i atdhetarizmit, Mehmet Shpendi, pas 100 vjetëve te rënies se tij, u vendos përjetësisht ne qytetin e Shkodrës, ne qytetin e kulturës, ne qytetin e atdhetarisë e personaliteteteve te shquara te nacionalitetit tone ...

Erdhi momenti i shume pritur, dorëzimi i urdhrit "Nderi i Kombit" ... Këshilltari diplomatik i Presidentit, zoti Flamur Gashi, lexoi dekretin e Presidentit te Republikës, zotit Bujar Nishanit: ... MEHMET SHPENDIT (pas vdekjes), Dekoraten "Nderi i Kombit", me dekret nr. 9165, date 13. 07. 2015, me motivacion: "Në shenjë mirënjohjeje për veprimtarinë e tij atdhetare si udhëheqës popullor, i



cili me armë në dorë dha një ndihmesë të çmuar e të patjetërsueshme për më tepër se katër dekada për lirinë dhe pavarësinë e trojeve shqiptare."

Pas duartrokitjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës, Fation Nuri, zonjës Prenda Mark Shpendi, io dorëzon dekoratën ... duartrokitje te vijueshme ...

Aktori i mirënjohur, Bruno Shllaku, ne mes te këtij entuziazmi, recitoi poezinë e Risto Siliqit "Mehmet Shpendi".

Pas mbylljes se kësaj ceremonie, pjesëmarrësit u larguan aq te kënaqur, sa edhe te mahnitur për këtë arritje te madhe ...

Për pak çaste, Gjergj Leqejza, priti ne mjediset e MADISH, një pjesë nga pjesë-

marrësit ...

Ne orën 12.00 u shtrua dreka për miqtë ne bar-restorant "TRADITA", me pronar Gjon Dukgilaj, te cilin e uruam me shprehjen popullore "E shtroftë trevesen gjithmonë për te mira ...!" Ne dreke, pas hapjes se saj nga Kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj, pati shume përshëndetje: Z/ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, Z/ministri i Kulturës, Zef Çuni, Gjergj Leqejza, Lorenc Luka, Sytki Ndreca, Pal Dreshaj, Ukshin Jashari, Gjon Dushaj, Kole Tonaj, Gjin Progni, Lazer Stani, Tom Shpendi, skulptori Skënder Kraja, Tome Balbona e te tjerë.

Ne një moment, Sekretari i Shoqatës,

Luigj Shyti, lexoi vendimet e Kryesisë se Shoqatës, për nderimin e disa personalitete kontribuuese ne këtë arritje. U nderua me titullin "Mirënjohja e Shoqatës": Lorenc Luka, kryetari i bashkise se qytetit Shkodër, me motivacion: "Për kontributin në promovimin e kulturës dhe historisë së Dukagjinit, dhe për mbështetjen veprimtarive të Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" në dobi të zhvillimit e përparimit social dhe ekonomik të këtij komuniteti". U nderua me titullin "Mirënjohja e Shoqatës", bashkësia dukagjinase ne Nju-Jork, për kontributin financiar qe kane dhënë, me motivacion: "Për kontributin e madh që dhanë në realizimin e nismës së Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" në vendosjen e monumentit të atdhetarit të shquar Mehmet Shpendit dhe albanologut Martin Camaj në qytetin e Shkodrës", i cili ju dorëzua zotit Tome Bal-



bona. U nderuar me titullin "Mirënjohja e Shoqatës, zoti Maxhid Cungu, Kryetari i Këshillit te Qarkut Shkodër, me motivacion: "Për kontributin në promovimin e kulturës dhe historisë së Dukagjinit, dhe për mbështetjen veprimtarive të Shoqatës "Atdhetare Dukagjini" në dobi të zhvillimit e përparimit social dhe ekonomik të këtij komuniteti".

Gjithashtu u nderuan me medaljonin "Mehmet Shpendi", zoti Toma Balbona, zoti Flamur Gashi dhe zonja Prenda Mark Shpendi.

Kënaqësinë e kësaj dreke e rriten këngëtarët Fran Kodra e Ndue Shytani, me këngët e tyre folklorike dhe atdhetare.

Redaksia e gazetës "Dukagjini" uron me gjithë zemër arritjen e shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"! Gjithashtu i uron te vijoje puna me këtë përkushtim, ne përvitimin e monumentit te Martin Camaj, ne ditët e para te muajit tetor 2015.

Lavdi jetes dhe vepres se Mehmet Shpendi, Nderi i Kombit!

Korrespondenti i Gazetës "Dukagjini"

# I paharrueshëm gjaku i të rënëve, në luftime për liri



Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" dhe Shoqata Patriotike e kulturore "Spani", morën masa për të përkujtuar 100 vjetorin e të rënëve për liri, në malet e Dukagjinit, në luftime me një ushtri të rregullt malazeze, në muajin korrik 1915.

U morën masa për rindërtimin e Lapidarit, i cili kishte pësuar dëmtime nga koha, për njoftimin e pjesëmarrësve, deri te Kryetari i Kuvendit, Qeveria, pushtetit vendor e te tjerë.

Me datën 15 korrik 2015, dite e mërkure, në orën 11. 30 filloi ceremonia në Qeresh, vendin ku 75 vjet me pare, paria e asaj kohe e gjithë Dukagjinit, vendosen qe ajo qëndresë, ajo luftime te

përkujtohet aty ku dhe u derdh gjak me shume, ne Qeresh.

Në fillim u dha himni i Flamurit ... U vendosen kurora pranë lapidarit nga Shoqata "Atdhetare-Dukagjini", nga Shoqata Patriotike Kulturore "Spani" dhe nga pjesëtar te familjes se Gjon Prekes (Vocaj), prej lagjes Than.

Hapjen e ceremonisë e beri Ndue Sanaj, qe ne mes te tjerave u ndal: "Jemi bashkuar në këtë qafe, që quhet qafa e Qereshit, për të përkujtuar ata, të parët tanë, që 100 vjet më pare derdhen gjakun e tyre për të qene të lire dhe të pavarur, në luftime me një ushtri të rregullt malazeze, në muajin korrik 1915.

Kishte filluar Lufta e Pare Botërore. Me 27 qershor, pasi ushtria e Malit te Zi, kishte pushtuar gjithë malësinë e Mbishkodrës, u fut në qytetin Shkodër. Në hapësirën prej 12-13 ditëve luftime, derdhen gjakun e tyre 106 vete, në Dukagjin dhe prej tyre, në këtë hapësirë, që shohim ne, nga qafa e Mgulles, në gryke Thane, në qafe të Qytezës, në Gropa të Strelit, në Pla' të Madh, Mbigure, në qafe Kuje e deri në Nderkiza të Planit, pra, në hapësirën e fshatit Plan-Gjuraj, derdhen gjakun 81 vete, në mes tyre tre gra dhe këta janë të shkruar në pllakën e këtij lapidari, që kemi përpara.

Ne, Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" dhe Shoqata Patriotike Kulturore "Spani", në këtë 100 vjetor bëme përpjekje të rindërtojmë lapidarin se, ai ekzistuesi i ndërtuar që në vitin 1970, ishte dëmtuar rende nga koha. Tani, jemi përpara këtij lapidari, që shikoni sot, pranë të cilin vumë kurora dhe lule. Gjithçka, që kemi kontribuar në rindërtimin e këtij lapidari dhe për përkujtimin e gjakut të derdhur të 81 të rënëve në këtë qëndresë, në këtë 100 vjetor të tyre, është dhënë për nderimin e gjakut të tyre, është dhënë për shpirtat e tyre, Edhe ne emrin tuaj, ju them: Këto kontribute Ju bëfshin drite! Pasardhëseve të tyre ju urojme shëndet e me jete të gjate! Zoti t' u japi sa shume jete për t' i kujtuar së bashku me ne, here pas here!

Për sigurimin e kësaj përkujtimore, në këtë kuadër, në kuadrin e 100 vjetorit të saj, kane kontribuar Gjin Bluda, me 5000-leke, Gjin Koçeku, me 5000-leke, Kole Kumbulla, me 3000 leke, Pashko Ara me vëllezër, me 5000 leke, Kujtim Livalli, me 5000 leke, Pëllumb Vrinca, me 5000 leke, Tome Noka, me 5000-leke, Valentin Preka, me 5000-leke, Pëllumb Ndoja, me

5000-leke, vëllezërit Tonin e Agim Vocaj, me 5 000 leke, Gjon Bungu, me 5 000 leke, .... dhe Shoqata "Atdhetare-Dukagjini, me 123 040 leke. Të gjithë, i falënderojmë me urimin popullor: Paçin e dhëncin!

Pastaj e mori fjalën Mhill Pali, Kryetar i Shoqatës patriotike kulturore "Spani", për te folur për këtë ngjarje, ne kuadrin e 100 vjetorit te saj ...

Ne emër te familjeve te dëshmoreve përhëndeti, Fran Gjini ...

Ne emër te Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", përhëndeti Kryetari i Këshillit te Shoqatës, Prele Shyani ...

Për te pranishmit, grupi artistik, Ndue Shytani, Fran Kodra, Pëllumb Vrinca, Ndok Leke e Kristian Zalli dhanë një program te pasur me këngë folklorike kush-tuar dëshmoreve te rene për liri ...

Në orën 13. 00 u mbyll ceremonia dhe pjesëmarrësit u nisen për Shkodër me grupe, te cilët rrugës dhe u argëtuan me ndonjë gote ...

Duhet falënderuar Ndue Ftoni, me banim ne Miçigan, i cili dërgoi gazetar te TV Shqiptar, pronar i te cilit është, Kole Vasilin e Tome Keqja, te cilët e filmuan te gjithë për ta dhëne ne Miçigan. Gjithash-tu duhet falënderuar TV STAR-PLUS, i cili dërgojë gazetarin Mark Gjeka, dhe ka dhëne pjese te kësaj ceremonie. Por është e turpshme, qe asnjë nga pushteti vendor te vjetër e te rinj nuk morën pjese ne këtë ceremoni, ne kuadrin e 100 vjetorit te Përballjes se Madhe te Dukagjinit, ne Plan, me forca te rregullta ushtarake malazeze ... Vërtetë, një qëndrim i papranueshëm i tyre ... Urojme te jete një lajthitje e momentit, prej kohës se nxehte, te mesit te muajit korrik

Lavdi për jete te rënëve për LIRI!

Korrespondenti i Gazetës "Dukagjini"



# PRENDA SHPENDI dhe oshtima e heshtjes së sajë



Prenda Shpendi 1980

Nuk e kisha njohur më parë. Për ta njohur u bë shkak puna që po bënim për ngritjen e shtatores së Mehmet Shpendit dhe përpjekjet për ta nderuar me titullin e lartë "Nderi i Kombit". Unë personalisht edhe gjatë punës në këtë drejtim nuk arrita që të takoj, por u takuan shokët e mijë. I pari që bëri të mundur lidhjen me këtë njeri, në pamjen e parë të heshtur, por që dukej se nuk ishte krejt ashtu, ishte Martin Bardhoj Martini, një kushëri i saj dhe, për më tepër me marrëdhënie shumë të mirë familjare dhe shoqërore me të. Unë e takova për herë të parë, nga afër dhe për tu njohur me të në ditën e përrurimit të shtatores së Mehmet Shpendit dhe marrjes së Urdhrit "Nderi i Kombit". Mu duke një grua zonjë, e përmbajtur, që shikonte shumë, por nuk ndërhynte, nuk ngacmonte, nuk pyeste për gjithçka e nuk jepte mend për gjithçka. Pasi qemë prezantuar nëpërmes Martinit, asaj ju duka shumë i afërt, por edhe të gjitha ata që janë marrë dhe po merreshin me këtë ceremoni. Në një moment i afrohem te stoli ku qëndronte, përballë shtatores së Mehmet Shpendit, dhe i them që të shkonte dhe të qëndronte në hije edhe disa minuta sa të fillonte veprimtaria. Ajo më pa gjatë në dritën e syrit dhe pastaj më tha: "po me duket se po rri me të, ai dha jetën në një ditë të nxehtë, e unë si të mos qëndroj pak minuta afër tij", sytë ju mbushën me lot dhe me vuri dorën në gjoks gjithë mirësi. Unë e pyeta pastaj nëse kishte ndonjë dëshirë që mund t'ia plotësonim në këtë moment. "Jo, -më tha, nuk kam asnjë kërkesë të veçantë, të gjitha i keni plotësue ju, Mehmet Shpendi nuk është ma vetëm i joni por tash është i juaj dhe i të gjithë Shqipnisë!"

Ceremonia kishte filluar dhe erdhi momenti i zbulimit të shtatores. Prenda, së bashku me të dërguarin e Presidentit të Republikës ftohen që të zbulojnë shtatoren. Afrohen pranë edhe disa nga përfaqësuesit e atyre që ndihmuan në realizimin e kësaj shtatores. Pasi hiqet mbulesa, Prenda afrohet edhe më pranë, ngre dorën dhe prekë me ëmbëlsi këmbën e bronzit të shtatores, e fërkon jo si metal, por sikur të ishte trup i gjallë, sytë e saj ishin mbërthyer në fytyrën e heroit e sytë e saj ishin mbushur me lot, por nuk e dha veten, kthehet dhe shkon në vend e pas disa çastesh ftohet që të marrë dekoratën e lartë "Nderi i Kombit", që i a kishte dhënë Presidenti i Republikës. Afrohet te mikrofoni, flet pak fjalë duke falënderuar të gjithë ata që bënë të mundur arritjen në këto momente. Ata janë fjalë të thjeshta, por me zemër të madhe.

Ndërsa bisedojmë një ditë më vonë me Prendën, ajo duke vënë dorën në zemër, me zërin që i dridhej nga emocionet thotë prerë: "Dita më e gëzuar e jetës time ishte kur u ngrit shtatorja e Mehmetit dhe marrja e titullit "Nderi i Kombit", e pas pak, pasi qetësohet disi thotë se në jetën e saj ka pas vetëm trazime. "Kam 85 vjet jetë dhe asnjëherë nuk kam pasur gëzim më të madh se sa ditën që ju bënë këto nderime axhës së babës tim, Mehmet Shpendit" dhe nga sytë i rollën pika loti. Ajo nuk di të gjejë fjalë për të falënderuar të gjithë ata që punuan në këtë drejtim, por vendosë dorën në zemër, sytë i drejton nga qielli dhe thotë: "Zoti jua ditët, jua priftë mbarë dhe ju ndihmoftë".

Një rrugëtim i shkurtër i jetës së Prendës

Prenda u lind më 15 korrik të vitit 1931, plot 16 vjet nga dita e vrasjes së Mehmet Shpendit. Jeta e saj është shumë e trazuar. Është e bija e Mark Sadikut, një nga burrat më të njohur të Pecajve, Shalës dhe Dukagjinit. Marku është djali i vëllait të Mehmet Shpendit. Mark Sadiku, i njohur për trimërinë dhe urtinë e tij, ishte me të gjithë fuqitë e tij në shërbim të krahinës dhe vendit në çdo kohë. Për veprimtari kundër pushtuesve italian internohet në Itali, deri sa kapituloi Italia. Ai, si shumë e shumë të tjerë në Pecaj, Dukagjin dhe në tërë Shqipërinë, ishte edhe kundër regjimit që po vendosej në Shqipëri deri në fund të jetës së tij.

Të detyruar nga regjimi i kohës, në vitin 1946, meshkujt largohen nga shtëpitë dhe qëndronin maleve për tu ruajtur nga arrestimet dhe vrasjet. Për këtë, forcat e ndjekjes në atë kohë i dogjën shtëpinë kësaj familje dhe marrin gra dhe fëmijë

dhe i internojnë për 7 muaj. Nën presionin e keqtrajtimit politik dhe shoqëror të familjes u detyruan që të dorëzohen të arratisurit. Me dorëzimin e tyre lirohen gratë dhe fëmijët nga internimi. Kishin filluar aksionet e kohës me rininë. Kërkonin edhe nga kjo familje që të merrnin "vullnetar". Radha i erdhi Prendës. Duke mos pranuar që të shkojnë në aksionet e rinisë; Prendën e përjashtuan nga organizata e rinisë. Vëllezërit e Prendës, që u dorëzuan, së bashku me shumë të tjerë në Shalë dënohen me burg, megjithëse nuk kishin fakte bindëse. Në fillim të vitit 1948 lirohen nga burgu dhe pas gjashtë muajsh organizohen dhe largohen për në Jugosllavi. Kjo erdhi për arsye, se nuk u pa asnjë mundësi dhe garanci jete.

Me shumë saktësi dhe pa mëdyshje Prenda tregon edhe vështirësitë e kalimit për në Jugosllavi. Ajo shpesh herë mbushet me frymë thellë, lëshon një oohh disi të gjatë dhe përsëri vazhdon. Nga familja jonë, kemi shkua unë, vëllaznit, Sadiku e Gjeta dhe kunata Age. Kalimi ishte mjaftë i vështirë, male të thepisura, rrugë të vështira, rreziku i forcave të ndjekjes, sigurimit të shtetit, reparteve kufitare, policisë, e të tjera. Kemi qëndruar dy janë në Rragam të Shalës. Me ushqime na furnizonte Ndre Cufa. Ishim një grup

i madh. Midis tyre ishte Padre Daniel Gjeçaj, Martin Camaj, Kolë Leka, Lekë Martin Preçi, Nik Sokoli i Btoshtës e shumë të tjerë. Nga Rragami patëm çua Pashko Cufën për tu marrë vesh në Jugosllavi nëse na prisnin, por atë e mbajtën atje. Një ditë na vjen Ndrethi, pa bukë e

ushqime dhe tregon se forcat e ndjekjes kanë ra në gjurmë tonë dhe duhet të largoheshim prej këtu sa më parë. U nisëm drejt kufinit, nëpër disa rrugë pa rrugë. Kujdeseshim që të mos rrëzonim gurë dhe mund të zbuloheshim dhe të binim në dorë të ushtrisë. Pasi hymë në tokën Jugosllave, ndalua dhe u vendosën në një pyll, disi të fshehur. Prej aty dërguam Lekë Martin Preçin që të merrte kontakt me autoritetet Jugosllave. Shumë shpejt erdhën shumë forca ushtarake me gjithë fare armatimi. Na morën dhe na çuan në kamp. Në kampet e ngritura nga shteti Jugosllav nuk kishte asgjë për të jetuar normalisht, natyrisht si të burgosur, apo të izoluar, tregon Prenda. Na lëviznin sa në një kamp në një tjetër, na kanë çuar deri në Kroaci. Koha prej 8 vjetësh, nga viti 1948 deri 1956, që kemi qëndruar në Jugosllavi kanë qenë shumë të vështira dhe nuk di si kemi mbete gjallë, -vazhdon ajo.

Kjo familje ka kaluar për në Francë,

në vitin 1956 dhe ka qëndruar aty deri në vitin 2005, kur është larguar edhe banori i fundit e kësaj familje, Prenda, për tu vendosur përfundimisht në Shqipëri. Qëndrimi në Francë dhe jeta, ishte më i mirë. "Punonim punë të thjeshta, sepse aq ishte mundësia jonë, -thotë Prenda, por pa punë nuk kemi mbete asnjëherë".

Gjatë qëndrimit në Francë kjo familje nuk pati rritje në numër të anëtarëve të saj. Në vitin 1974 vdes Gjeta dhe varroset atje, ndërsa në vitin 1999 vdes edhe vëllai tjetër Sadiku. Është për tu theksuar së Prenda bëri një akt shumë të fuqishëm në kohën që vdes Sadiku. Me guxim, ndoshta edhe në kundërshtim edhe me ndonjë të afërm të saj, vendos që të vëllain e sapo vdekur dhe eshtrat e vëllait të vdekur më parë të varroset në tokën dhe varrezat e të parëve të tyre, në Pecaj të Shalës. Vendos vëllain e sapo vdekur në ngrirje dhe merret për disa ditë me dokumentet e Gjetos, pasi kishin refuzuar shtetësinë Francezë, sepse donin që të mbetnin vetëm shqiptar. Më në fund merret leja për të zhvarrosur dhe të dy arkivolet sillen në Tiranë, dhe po atë ditë sillen me helikopter nga Tiranë në Pecaj, ku kryhet edhe ceremonia mortore për të dy, shqiptarçe, dhe varrosen në varret e të parëve të tyre, më 26 korrik 1999.



Nga fundi i bisedës e pyes Prendën, për jetën e saj personale, veçanërisht nëse ka qenë e martuar. "Nuk jam martue kurrë, dhe nuk jam pendue, sepse po të isha martuar mundet se nuk do të kisha ba punët që i kam ba, nuk do ti kisha mbledhë eshtrat e njerëzve të mijë, veçanërisht të vllaznëve të mijë, aty ku ata kishin shprehur dëshirën, në vendlindjen tonë, në Pecaj".

Në muret e dhomës së pritjes në shtëpinë e Prendës janë plotë foto të viteve të hershme të kësaj familjeje. "Këto kanë shumë rëndësi për mua, -thotë Prenda, me to flas, s'lodhem, përmllohem, pse jo edhe lotoj, e, të lotosh për njerëzit e tu nuk është dobësi, por është kujtim respekt dhe dashni."

Largohemi nga kjo shtëpi, nga kjo grua fisnike, e fortë dhe e zgjuar, por e heshtur e kjo heshtje ka një oshtimë që e përcjellin malet ...

Luigj SHYTI  
18 korrik 2015

# Camaj, mërgimtari që e mori atdheun me vete

I detyruar të linte vendlindjen kur ishte vetëm 18 vjeç, shkrimtari i madh Martin Camaj e mori atdheun me vete në krijimtarinë e tij letrare, duke u qëndruar përjetë besnik alpeve. Sot bëhen 90 vjet nga lindja e shkrimtarit, akademikut e albanologut

“Ndonëse të ndamë për një gjysmë shekulli, unë jam i juaji e ju jeni të mijtë”...Kështu shkruante shkrimtari i madh Martin Camaj përpara se të ndahej nga jeta në mars të vitit 1992.

Sot, poeti, prozatori, akademiku, albanologu do të mbushte 90 vjeç.

Shqipëria e largoi në moshë kur sapo kishte mbushur 18 moshë, por ai nuk e la kurrë Shqipërinë në motivet e letërsisë së tij. E nuhati diktaturën qysh në fillimet e saj dhe kjo e bëri të arratiset për t'i siguruar vetes studimet.

Pasi u largua nga vendlindja, fshati Temal, vëllimet e para poetike “Një fyll ndër Male”, “Kanga e Vërrinit”, i botoi në Prishtinë.

Në Beograd u shpërngul për të mbrojtur titullin doktor i shkencave me “Meshari i Buzukut”. Nuk kishte qenë rastësi që shkrimtari zgjidhi veprën e parë të shkruar në gjuhën shqipe, duke treguar sesa të forta i mbante lidhjet me të. Më pas udhëton drejt kryeqytetit italian, ku bashkë me Koliqin themelojnë revistën “Shejzat”.

Ndalesa e fundit në Mynih të Gjermanisë, ku hapi degën e Albanologjisë në universitetin e qytetit, për të sjellë pranë atdheut prej të cilit ishte larguar, i detyruar.

Sipas studiuesit Behar Gjoka, Camaj e mori me vete atdheun, me gjasë e përlindi atë në tekstet letrare dhe studimore, që arriti kulmin me “Gramatika e shqipes”.

Ai nuk i shkëputi asnjëherë lidhjet me Shqipërinë, por ndoqi me vëmendje çdo zhvillim të jetës politike, kulturore dhe asaj letrare.

Ismail Kadare e quan Martin Camajn shkrimtar të lartësive.

“Ndjesia e parë që provon lexuesi kur hyn në botën letrare të Martin Camajt është ajo e lartësisë. Pa përjashtuar përfundimisht eufemik të shprehjes, atë që ka lidhje me gjithë shkrimtarët e mëdhenj të një letërsie, te Camaj shprehja merr një kuptim të mirëfilltë. Në shumicën e veprave të tij, në mjediset e përkrahura, në klimën e tyre, te personazhet, ajri, madje dehjet e shëndetshme apo të turbullta që vijnë prej tij, janë ato të alpeve”, – ka shkruar Kadare, duke u shprehur se mënjanimi i tij nga bota, i projektuar në lartësinë dhe pastërtinë e maleve vinte nga vetmia e tij.

“Martin Camaj ka qenë, pa dyshim, shkrimtari më i vetmuar shqiptar i gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë. Duke i strehuar ngjarjet dhe personazhet e veta në një lartësi, që iu siguronte pavarësinë, ka kujtuar ndoshta se do ta mbronte artin e tij prej ndikimit të krahurës shqiptare, asaj së cilës kujtonte se i kishte lënë lamtumirën”, – është i mendimit shkrimtari Ismail Kadare.

Martin Camaj, mërgimtar i përjetshëm në gjallje dhe në amshim, mërgimtari i përvëlur për atdhe, që e mori me vete



atdheun, e përlindi si prani shpirtërore në zhguallin e shqipes, të lëvruar në tekstet letrare dhe shkencore, studimore dhe gjuhësore, i ngriti një kult gjuhës shqipe, ligjëritim letrar të gegnishtes dhe arbërishtes.

Në vetmi, rrallëherë i kuptuar nga njerëzit, Camaj vazhdonte veprën e tij, duke u përpjekur të ruante dritësimin e saj alpin, qoftë në poezitë, qoftë në prozën e tij. Ishte pakti i tij i pandryshueshëm me artin, me lartësitë e bjeshkëve nga kishte dalë, e ku një ditë shpresonte se do të kthehej.

“Sdue me qenë si moti i lig, kumtonte në një nga vjershat, duke shpallur kështu kthjelltësinë e fisme mbi pasionet politike, e sidomos mbi mllefet, pa të cilat ishte vështirë të përftohej bota shqiptare...”

Alpet dhe letërsia

Martin Camaj u lind më 21 korrik 1925, në një zonë malore, në Temal të Shllakut. Ashpërsia dhe vërtetësia e maleve do të linin përgjithmonë gjurmë në krijimtarinë letrare të Camajt.

Ndoqi mësimet në kolegjin Saverian, në Shkodër; një kolegji me emër në të cilin kishin studiuar patriotët, shkrimtarët, gjuhëtarët dhe mësues të afirmuar në profesionin e tyre. Pasi mbaroi studimet nisi punë si mësues në fshatin Prekal. Bindjet e tij nuk pajtoheshin me regji-

min e kohës, prandaj në vitin 1948, në moshën 23-vjeçare arratiset për në Jugosllavi. Pas disa peripecish, ai filloi studimet e larta në Universitetin e Beogradit, në degën Gjuhë-Letërsi Sllave dhe latine, pranë profesorit të dëgjuar kroat, Henrik Bariç. Menjëherë prirjet e tij letrare i konkretizoi me botimin e dy vëllimeve poetike “Nji fyell ndër male” (Prishtinë,

më shumë formimin e tij filologjik. Zgjidhi temë disertacioni veprën e parë të gjuhës shqipe “Mesharin” e Gjon Buzukut. Fillimisht Martin Camaj do të jetë lektor në Universitetin e Romës pranë katedrës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe, që drejtohej nga shkrimtari E. Koliqi, por njëkohësisht që për disa vjet qe edhe kryeredaktor i revistës prestigjioze “Shejzat” (Le Pleiadi) (1957-1978) që dilte në Romë. U largua drejt Gjermanisë, 10 vjet pas qëndrimit në Romë duke u vendosur në Mynih, ku do të merret kryesisht me studime gjuhësore. Në Universitetin e atij qyteti do të mbrojë me sukses një temë nga fusha e formimit të fjalëve të shqipes, të titulluar “Fjalëformimi i shqipes. Mënyrat e formimit të emrave të vjetër”. Në Mynih jo vetëm do të mbajë leksione për studimet albanologjike, por pas disa vjetësh do të themelojë katedrën e gjuhës shqipe në atë universitet që do ta drejtojë gjatë 20 vjetëve, prej vitit 1971-1990, vit në të cilin doli në pension. Autori ynë do të jetë një personalitet i cili do të vlerësohet nga instancat shkencore të kohës dhe redaksitë e disa revistave që dilnin në Evropë. Martin Camaj punoi afro 15 vjet për romanin “Rathë” – një nga veprat madhore më të zgjedhura të prozës sonë bashkëkohore, qoftë për vlerat njohëse që përmban, qoftë për depërtimin dhe zbërthimin e dukurive të jetës shqiptare apo për stilin e ngjeshur, me atë fjalor të pasur, shtjellim dramatik të natyrshëm.

Martin Camaj solli ndihmesë të vyer edhe në rrafshin e studimeve të folklorit. Martin Camaj, me punën e tij të zellshme si docent i Albanologjisë në Universitetin e Mynihut, e më vonë si shef katedre, arriti ta lartësojë atë degë në qendër hulumtuesh akademike, e cila sot gëzon statusin e “Fachstudium” dhe jep tituj pasuniversitarë si “Magjistër”, “Doctor Philosophies”.

Vdiq larg vendlindjes së tij, në Bavari në Epërme, në fshatin malor Lengries, më 12 mars 1992, në moshën 67-vjeçare nga një sëmundje e pashërueshme pranë së shoqes, Erika. Edhe pse regjimi në Shqipëri u përmbys, ai nuk mundi më ta shohë vendlindjen.

Marrë nga gazeta “Dita”,  
21 korrik 2015

## NDAHET NGA JETA MESUESI NIKOLL HEBAJ



Pas një sëmundjeje të gjatë e të pashërueshme u nda nga jeta mësuesi i nderuar, Nikoll Heba, që punoi për 28 vjet në arsim, në shkollat e Shllakut.

Nikoll Heba, lindi me 20. 03. 1962 në fshatin Vukaj, të Shllakut, në një familje të njohur. Pas mbarimit të shkollës së mesme në Shllak, vijoi studimet në Universitetin “Luigj Gurakuqi” dhe kreu fakultetin e shkencave të edukimit për mësues të Ciklit të Ulte. Punoi mësues në disa fshatra të Shllakut dhe 8 vjet si drejtues shkolle. Ai, ishte shembull në familje dhe një komunikues i mrekullueshëm me nxënësit dhe banoret e fshatit të tij. U angazhua në pushtetin lokal si kryetar i fshatit.

Vdekja e tij ishte një humbje e madhe për pjesëtarët e familjes, për të afërmit, për grupin arsimor e banoret e Shllakut. Mungesa e këtij intelektual do te ndihet gjatë, për vlerat e mëdha që kishte ky njeri për këtë zonë. Shprehim ngushëllimet bashkëshortes së tij dhe dy fëmijëve, për këtë humbje te parakohshme!

Përgatiti, për gazetën “Dukagjini”, Zef Nika

## DEKLARATË

Ne, Shoqata "Atdhetare Dukagjini" jemi të befashuar, të shokuar dhe thellësisht të hillëruar për vrasjen e dy turistëve çek në territorin e fshatit Ura e Shtrenjtë, nga biri i Dukagjinit. Ky akt kriminal na ka prekur thellë të gjithëve. Edhe ne ndjejmë përgjegjesi për këtë ndodhi. Nuk pajtohemi asnjëherë me të. Ne i mirëkuptojmë dhe i respektojmë edhe shprehjet e ndryshme emocionale në rrjetet sociale, të cilët, besojmë se, nuk duan hakmarrje primitive, por është shprehje e revoltës shpirtërore, por, edhe mosbesimt ndaj pushtetit gjyqësor në Shqipëri e që duhet të dëgjohen mirë nga shteti dhe gjithë sistemi gjyqësor.

Ju shprehim ngushdhimet prindërve dhe familjarëve të dy turistëve të vrarë barbarisht, dhe ju kërkojmë falje publikisht. Ne jemi prindër, jemi familjarë dhe e dimë mirë se çdo të thotë një krim i till ndaj dy të rinjëve krejt të pafajshëm, të cilët ishin vetëm dashamirës të krahinës tonë. Ne nuk mund të pranojmë këtë krim, prandaj dhe distancohem plotësisht dhe publikisht.

Ne u garantojmë turistëve të huaj dhe të gjithë rrugtarëve të tjerë, se do të punojmë me të gjitha fuqitë dhe do të bashkëpunojmë me të gjithë faktorët dhe aktorët që rrugët dhe territoret tona të jenë të sigurtë në të ardhmen, në çdo kohë të ditës dhe natës.

Veprimi kriminal i një njeriu, që vërtetë është shumë i shëmtuar dhe i dënueshme ligjërisht dhe tradicionalisht, nuk duhet dhe nuk mund të fshijë gjithë historinë, kulturën dhe traditat e mira të një krahine.

Kemi pasur, ka edhe sot, shumë familje me nivel shumë të ultë ekonomik, arsimor dhe kulturor, por janë të nderuara dhe të respektuara në fshat apo krahinë.

Ne mendojmë se edhe shteti ka përgjegjësi, sepse ai duhet: të kërkojë llogari dhe të vendosë para përgjegjësisë organet gjyqësore që me veprimin dhe mosveprimin e tyre, çojnë në krijimin e kushteve për krime të tilla, të punohet për zhvillimin e krahinës si domosdoshmëri për edukimin e njerzve ku parësore është lidhja e rrugës së asfaltuar Prekal-Shalë-Qafë e Tërthores, dhe, krijimi i kushteve për punësim dhe shkollim më të mirë, dhe të vendos, në mënyrë të përhershme të posta policie në Theth dhe Prekal, si pika fundore, hyrje-dalje të Dukagjinit.

Ftojme të gjithë komunitetin dukagjinasi që të na mbështesin sa u tha në këtë deklaratë, për sot dhe për të ardhmen. Ne kërkojmë që me guxim dhe vendosmëri të dënojmë veprimtarinë kriminale ndaj dy turistëve çek dhe gjithë të huajve, por edhe brenda vendit. Të ngremë opinjonin publik ndaj të gjithë atyre që do të guxojnë të ngrenë dorën kundër jetës dhe pasurisë së tjetrit, kundër ligjit, duke kryer veprime kriminale.

KRYESIA E SHOQATËS "ATDHETARE-DUKAGJINI"

Shkodër, më 08.7.2015

## Një shtatore për "gjeneralin e maleve" në Shkodër

Qyteti i madh i veriut në lindje të tij dhe akoma më mirë në veri lindje ka malet, ka alpet dhe kryesisht historinë e rezistencës dhe luftës popullore kundër çdo pushtuesi. Shkodra është qyteti që ka përballuar rrethimet më të mëdha dhe ushtrive më të mëdha rrethuese, por rreth saj ka pasur gjithmonë edhe luftëtarët më të shquar popullor si prijës të banorëve të ashpër, por të lirë të këtyre maleve. Dje, në Shkodër u vendos një shtatore e luftëtarit dhe patriotit të vrarë në luftë me malazetë, ose gjeneralit të vërtetë popullor të maleve të Dukagjinit, Mehmet Shpendi. Ishte shoqata "Dukagjini" dhe shqiptarë jashtë vendit që organizuan dhe bënë të mundur këtë shtatore të punuar nga Skënder Kraja. Në këtë eveniment të mirë organizuar ishin të pranishëm zëvendësministri i Kulturës, Zef Çuni, zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, Kryebashkiaku në detyrë Lorenc Luka, Maxhid Cungu, Bardh Lohja dhe shumë autoritete të tjera të Shkodrës. Po kështu, luftëtarit të madh popullor ju akordua dhe një dekoratë nga Presidenti i Republikës dhe nderimet për veprën e tij vazhduan si kujtim i madh ndaj një njeriu që nuk u përku.

Duke punuar dikur në Arkivin e Muzeut të Shkodrës, më kanë dalë përpara syve shumë faqe të rëndësishme referencash për këtë patriot. Një nga njerëzit që ka mbledhur dhe treguar qartë e mirë historinë e jetës së tij është dhe kolegu Prel Milani, por për të ka folur historia prej kohësh. Një tjetër nga zërat e fortë është Edit Durham e cila thotë: Një krijesë e çu-

ditshme me sy të zinj, i shkathët i veshur me xhamadan të kuq të qëndisur me ar. I stolisur me jelek të argjendit, me armë të ngrira në brez, me qystekun varur gjithë finesë, qelibarin e duhanit dhe sathatin e derdhur i tëri. Shpendi është një lider komandant popullor pa ofiqe, tepër aktiv dhe i madh në lëvizjet anti turke dhe xhonturke, që donin të çarmatosnin popullin shqiptar dhe sidomos malësorët. Vitet 1910-1912 janë kryengritjet e mëdha që e bëjnë këtë figurë vigane. Po ashtu, ai është një malësor i jashtëzakonshëm në luftën e viteve 1915 kundër malazetëve, ku dha edhe jetën.

Kanë folur për të, edhe shumë studiues të tjerë. Një ndër ta thotë: Mehmet Shpendi ka qenë i pari (kryetar) i djelmisë së Shalës, për sa që gjallë nën drejtimin e tij djelmia e Shalës mbritti të quhej paria më e fortë popullore pa të cilën flamurtari as krerët nuk nepnin vëndime" (Dom Ndoc Nikaj, Kujtime të Jetës kalume AQSH, Dosja nr12). Ndërsa Baroni austriak Nopça, djelmënë e Shalës të drejtuar nga Mehmet Shpendi e quan opozitën e parë shqiptare në gjirin e shoqërisë malësore të asaj kohe. "Mehmet Shpendi krijoi shumë armiq, sidomos ndër ata që nxirrnin fitime, por nuk e vuri ujën në zjarr për ta sepse në anën tjetër bani për vete krejt vegjël. (Nopça.FR Das Katholshe Nordalbanien Eien1.907). Akoma më mirë shkruan Prel Milani ku thotë: "Gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Mehmet Shpendi luftoi në Pipër, Velikë, Rozhnicë e Kërnice. Ndërsa që në vitin 1883 së bashku me Dedë Gjon Lulin kundërshtoi i pari komisionin e Xhibalit tek çezmja e Kopli-

kut ashtu siç ishte pozicionuar edhe më përpara në Rjoll dhe Lohe qysh më 1879".

Por në jetën e tij të pasur me aktivitete patriotike spikasin dy çaste kulmore. Kryengritja e Qafës së Agrit e vitit 1910, ku u sfidua Turgut Gazi (Fitimtari) Pasha dhe zënia rob e 1500 ushtarëve e oficerave malazetë, të cilët jo vetëm u sfiduan por edhe u turpëruan pasi qenë të detyruar të kalonin të çarmatosur nën këndin e krijuar nga kryqëzimi i dy pushkëve të përkulur bajonetë me bajonetë, që për dukagjinsit ishte "harku i triumfit". Beteja e Agrit ishte një shkollë e shkëlqyer e artit të luftimit mbrojtës sepse bllokoi për dy javë rresht 3500-4000 forca turke të pajisura me artileri e kavaleri. Pas kthimit të detyruar nga Puka në Shkodër, Turgut Pasha shpalli amnistinë e përgjithshme për kryengritësit e Dukagjinit, por Mehmet Shpendi nuk pranoi të dorëzohet, pasi e dinte se ky ishte një kurth i pabesë për ta futur në qark së bashku me bashkëpunëtorët e vet më të ngushtë që vazhduan qëndresën maleve të Dukagjinit.

Mehmet Shpendi në bashkëpunim me Dedë Gjon Lulin, Luigj Gurakuqin, Hilë Mosin e disa patriotë të tjerë malsorë nënshkruajnë Memorandumin e Gerçës, (23 qershor 1911) ndërsa që më përpara, me 30 mars 1911 së bashku me Isa Boletinin dhe Dedë Gjon Lulin kishin nënshkruar një Memorandum drejtuar fuqive evropiane me të cilin kërkonin autonominë e Shqipërisë.

Me 18 Mars 1911, Mehmet Shpendi i shkruan një letër Komitetit për Shqipërinë e Lirë në Romë, i cili e informonte: "Të nderuar Komitete për Shqipërinë,

Podgoricë me 18 03.1911. Duke vijuar përpjekjen për çështjen tonë kombëtare, morëm vesh se në Romë gjendet Komiteti juaj i nderuar. I shtyrë nga dëshira e atdhetaria marr guximin që me këtë letër t'u vë në dijeni të ngjarjeve të ndodhura dhe të disa problemeve të tjera, për të cilat mendoj se jemi në një mendje...".

"Në valën e fuqishme të Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912, Mehmet Shpendi përkrah Bajram Currit në krye të forcave të pararojës shqiptare luftoi për çlirimin e Shkupit, duke qenë udhëheqësi i luftëtarëve dukagjinasi në këtë eveniment të rëndësishëm kombëtar", citon historiani i mirënjohur Pal Doçi në monografinë historike kushtuar këtij fatosi të martizuar, të atdheut.

Edhe një herë në fillim të korrikut 1915 sfidon Kostandin Nikiçin por pikërisht me 15 korrik 1915 vritet dhe masakrohet barbarisht nga hordhitë malazeze në Plan të Dukagjinit së bashku me 79 malësorë të tjerë njëherazi duke qenë dhe sot e kësaj dite jo vetëm një pishtar i madh i patriotizmit, por dhe legjendë e madhe luftime. Ai është përmendur dhe në momentet e historiografisë së dikurshme, por në shumë raste është anashkaluar nga ajo për shkak të veprimtarisë antikomuniste të djalit të tij Pjetër Shpendi në vitin 1944. Një luftëtar si ai, një person i vegjëlisë së krahinës së Dukagjinit, duhej nderuar dhe kësaj rradhe shtatorja e tij është në të mirë të historisë dhe momentit për të reflektuar për të.

Marrë nga gazeta "Sot", date 17 korrik

# “Dita e Bjeshkës” në Theth

Dita e bjeshkës është propozuar nga Administrata e Zonave të Mbrojtura të Qarkut Shkoder, është diskutuar me banoret e zonës së Thethit dhe pronarë të bujtinave dhe është rënë dakord që dita e bjeshkës të jetë 25 qershor.

Dita e bjeshkës është në vetvete një ditë e veçantë për të gjithë banorët e zonës së Thethit, është dita kur banorët e kësaj zone çojnë bagëtitë në bjeshkë ku të gjithë banorët janë të angazhuar në këtë eveniment, është një ditë shprese, pas një dimrit të gjatë që mbretëron në këtë zonë. Dita e bjeshkës është edhe një ditë e rëndësishme takimi i të gjithë banorëve, pronarëve të bujtinave dhe administratës së zonave të mbrojtura për të shkëmbyer përvojat dhe eksperiencat me të mira që kanë të gjithë aktorët që operojnë në parkun kombëtar Theth.

Agenda e ditës së bjeshkës ishte shumë pasur me tematika të ndryshme ku referuan tematika të ndryshme.

Drejtori i AKZM z. Zamir Dedej foli mbi rolin e shume të madhe që kanë administrata e zonave të mbrojtura dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe në veçanti të parkut kombëtar në Theth, sfidat që presin këtë administratë në ardhmen. Rritjen e kapaciteteve njerëzore, përmirësimin e infrastrukturës, edukimin mjedisor. Ndryshimin e konceptit të funksionit të administratës së zonës së mbrojtur duke përqendruar jo vetëm në ruajtje e në menaxhim të parkut por edhe si promovues vlerash të bukurive natyrore dhe të Biodiversitetit, trajnime të guidave turistike si dhe të pronarëve të bujtinave për

tema të ndryshme që lidhen me turizmin, agrobiodiversitetin komunikimin, bash-



këpunimin dhe turizmin e qendrueshëm etj.

Profesor Luigj Shyti foli mbi historinë e zonës së Thethit ku dhe shtrihet dhe parku kombëtar.

Ndërsa Zef Bari foli mbi traditat dhe zakonet të zonës së Thethit.

Ing. z. Nihat Dragoti përfaqësues i INCA foli mbi zoonimin e parkut të alpeve i cili do të jetë një sipërfaqe 85000Ha ku do të jenë bashkë Vermoshi, Boga, Thethi, Valbona dhe Lumi i Gashit.

Diskutimi me aktorët lokale do të jetë vazhdueshëm, i pa ndërprerë për të patur sa më harmoni mes të gjithë aktorëve shtetërorë dhe lokale në ruajtjen e dhe

menaxhimin e vlerave të rralla që ka zona në funksion të zhvillimit të turizmit të qen-



drueshem pa i cenuar keto vlera.

Z. Luan Dervishej GIZ(CABRA) trajtoj temën e agrobiodiversitetit në zonën e alpeve, zhvillimi i qëndrueshëm të turizmit. Dha disa të dhëna mbi një projekt që po zbatohet në disa fermerë në Theth dhe në Nderlysa, ku janë ndërtuar disa sera për kultivimi e llojeve autoktone të domate, kastravecit dhe llojeve të tjera qëllimi është të ruhet pasuria gjenetike e kësaj zone si dhe arritja e mbulimit të nevojave të turizmit që ka zona.

Koncerti muzikor me grupin “Treva” Me këngëtarët Z. Ndue Shytani dhe Z. Fran Kodra.

Inaugurimi i një table informative nga GIZ(CABRA)

Në këtë ditë u arrit që të promovohen vlera të zonës së Thethit që shtrihet parku kombëtar e cila u arrit shumë mire nëpërmjet disa mediave kombëtare dhe lokale TVSH, VIZION PLUS, TOP NEËS, TV KOPLIKU, STAR PLUS etj, si dhe media shkruar kombëtare dhe ndërkombëtare etj.

U hodhën piketat e shëndosha për vitin e ardhshëm.

U krijua një ure e re lidhëse shumë e mire mes administratës së parkut (AdZM), banorëve, pronarëve të bujtinave, operatore turistike, pushtetit lokal.

TONIN MACAJ

## Mehmet Shpendi arriti panteonin e pavdeksisë

Me 16-07-2015 Sot në zbulimin e shtatorës së Mehmet Shpendit .

MEHMET SHPENDI “NDERI I KOMBIT”, NE PANTEONIN E PAVDEKSISE

Me ceremoni shumë të bukur, në të gjitha drejtimet, sot me datën 16 korrik 2015, u përrua shtatorja në bronz e atdhetarit Mehmet Shpendi në sheshin e Zonës Industriale të qytetit Shkodër. Shtatorja është e artë 2.5m dhe së bashku me bazamentin në 3.7m. Skulptori Skender Kraja e ka punuar me shumë pasion. Në këtë ceremoni morën pjesë shumë qytetarë të Shkodrës, Dukagjinit, Malësisë së Madhe, Mirditës, Nikaj Mërturit, Tiranës, bashkëatdhetarë nga Kosova, Mali i Zi, etj. Erdhën për të marrë pjesë në këtë ceremoni edhe disa bashkëkohorë nga Nju Jorku, të cilët mbajtën edhe peshën kryesore të fondeve financiare , erdhën nga Brukseli, Italia, etj.

Erdhën edhe të dërguar të Presidentit të Republikës të cilët dorzuan edhe dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” familjarëve pasardhës të Mehmet Shpendit. Erdhën edhe Zv/ ministri i mbrojtjes, dhe Zv/ ministri i kulturës, si dhe pothuaj të gjithë drejtuesit vendor të Shkodrës. Banda e qytetit mbushi mjedisin me bukuri dhe tingujt e saj të bukur dhe të fuqishëm. Vendi që zbuluar me flamurë



Kombëtar dhe të shoqatës Dukagjini. Një grup i madh të rinjshë ishin veshur me veshjet tradicionale të krahinës së Dukagjinit. Megjithatë një vapë përvëluese, kjo ceremoni shkoi krejt mirë. Pas zbulimit, në shtatorën e Mehmet Shpendit u vendosën tufa me lule edhe nga vëllezërit tonë jashë kufirit shtetëror të

Shqipërisë. Pastaj u organizuar një drekë shumë e këndshme në Barë restaurant Tradita, me pronar zotin Gjon Dugilaj, ku për disa orë vloy kënga e vallja si dhe u bënë shumë përshëndetje, u bënë foto si kujtim i kësaj dite të shënuar për komunitetin dukagjinas dhe shkoderanë, pse jo edhe kombëtar.

Mehmet Shpendi arriti panteonin e pavdeksisë.

**Frasher Racaj**

Sekretar i Shoqatës së Vllazërisë Kosovë - Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”

# FALEMINDERIT MIQ!

## PËRSHËNDETJE NË DITËN E PËRURIMIT TË SHTATORES SË MEHMET SHPENDIT

Në rreshtat e Himnit tonë kombëtar, midis të tjerash thuhet:

"...Trim burrë quhet dhe nderohet, atdheut kush iu bë thërror.

Përjetë ai do të kujtohet mbi dhë, nën dhë si një shenjtor..."

Kjo përmendore historike e Mehmet Shpendit, për veprën e tij heroike, punuar me mjeshtri dhe shumë frymëzim nga skulptori Skënder Kraja, ndihmuar nga bashkatdhetarët dhe më gjerë, por edhe nga dukagjinast tonë këtu, me mendimin, punën dhe organizimin e palodhur të shoqatës "Atdhetare Dukagjini" flet shumë për të shkuarën tonë, këshillon për të sotmen dhe hedhë vështrimin drejt të ardhmes. Mehmet Shpendi, jeta e tij dhe bashkëlufëtëtarëve të tij, të mishëruara në këtë shtatore, ishin në një kohë kur nuk ishim ne, por, që ne të ishim sot, e do të qëndrojmë këtu, si dëshmi për brezat edhe pasi të largohemi ne nga kjo botë.

Nderi dhe lavdia u takon atyre që nuk shkojnë në kuvende apo frontin e luftës me dy mendje, a po vendosim apo e lëmë hapur kuvendin, apo po shkojnë në luftë për të fitur apo po bëjmë si të shohim, por shkojnë të vendosur për luftë dhe fitore, u takon atyre që nuk kursejnë jetën e tyre për të ardhmen e popullit, për liri e përparim shoqëror.

Ndër dhe lavdi për jetë veprës së Mehmet Shpendit dhe bashkudhëtarëve të tij për në botën tjetër në verën e vitit 1915 në Malet e Planit të Dukagjinit, detyruar nga plumbat e pamëshirshëm të armëve armike, nga plumbat e pushtuesve e tradhtarëve. Gjakun e të rënëve për liri e përparim shoqëror bie dielli e nuk e thanë, bie shiu e nuk e lanë. Kështu ndodhi edhe më gjakun e të rënëve në Plan, i cili nuk është "tharë", e as nuk është "larë" edhe pse kanë kaluar 100 vjet, e kështu do të jenë edhe në të ardhmen.

Njeriu vdes kur harrohet. Ata që për atdhe, për përparim e zhvillim nuk kursyen asgjë natyrisht që varrosen një ditë, por nuk vdesin. Ata nuk harrohen prandaj nuk vdesin. Të tillë do të mbeten gjithmonë Mehmet Shpendi së bashku me trimat e trimëreshat dukagjinase që dhanë jetën në Malet e Planit në atë verë të nxehtë nga dielli i kohës por më shumë nga flaka e pushkëve vrastare të pushtuesve e nga zjarri i shtëpive të djegur.

Njeriu edhe mund të bie, por i lumtur është ai që ngrihet përsëri. Ata që kanë

dhënë dhe japin jetën për liri e përparim e vendit të vet ngjiten në piedestalin e historisë për të mos u harruar kurrë. Të tillë janë dhe do të mbeten të gjithë



ata burra e gra nga Dukagjini që u bënë flakadan për tu ndriçuar në shekuj rrugën brezave.

Gjaku i Mehmet Shpendit dhe trimave e trimëreshave që vdiqën bashkë, nën breshëritë e barbare të pushkëve armike, rrodhi së bashku me ujin e pastër të lumit Kir dhe ja ku mbiu, këtu po buzë Kirit, kjo përmendore e pavdekshme, në gjirin e Shkodrës mikpritëse, në Shkodrën e historisë dhe kulturës së lashtë dhe të re. Ata që vdiqën ato ditë korriku në Plan, kapën, ballëllartë, panteonin e lavdisë së përjetshme.

Fjala, besa, nuk vriten, nuk pushkatohen, nuk dobësohen. I tillë ishte edhe qëndrimi i Mehmet Shpendit me bashkëlufëtëtarët e tij, të cilët nuk u gjuhëzuan edhe pse të lidhur në pranga, edhe pse të rrethuar nga tytat dhe bajonetat e armëve armike, por në momentet e fundit u çuan fjalë bashkëlufëtëtarëve të tyre me shenjën "të tërhiqet gackeqja e pushkës" që do të thoshte të mos dorëzoheshin, por të vazhdonin qëndresën.

Shoqata "Atdhetare Dukagjini" dhe mbështetësit e saj, synuan që të gjejnë

pika që na bashkojnë. Dëgjuam ata që prodhonin "pse", por përpoqëm vetë, dhe bashkëpunuam ngushtë më ata që prodhuan ide. Në guxiam, guxiam, dhe,

veprës së Mehmet Shpendit, ndaj Shoqatës "Atdhetare Dukagjini", ndaj komunitetit dukagjinast dhe shkodranë kudo që ndodhen. Përsëritet Sekretarit të Përgjithshëm të Presidencës Zotit Florian Nuri dhe grupit që e shoqëron sot këtu.

Përsëritet Zv/ministrin të Mbrojtjes zotit Petro Koçi, Zëvendës Ministrin të Kulturës zotit Zef Çuni. Kryetarin të Këshillit të Qarkut Shkodër zotit Maxhid Cungu, Kryetarin të Bashkisë Lorenc Luka dhe Kryetarin të Këshillit të Bashkisë Bardhyl Lohja, për pjesëmarrjen dhe mbështetjen e tyre.

Përsëritet me shumë respekt të gjithë dhuruesve që bënë të mundur mbulimin e shpenzimeve për ngritjen e shtatores së Mehmet Shpendit që po përurojmë sot dhe atë të Martin Camajit së afërmi, veçanërisht bashkëkrahinarët tonë, dhe më gjerë, në Nju Jork, të cilët mbajtën edhe peshën kryesore, por edhe, anëtarëve të shoqatës dhe dashamirësve të saj në Shqipëri, të afërmeve të

Mehmet Shpendit, bashkëkrahinarëve tonë në Miçigan, në Belgjikë, etj. për ndihmesën e tyre. Përsëritet bashkëkrahinarëve tonë që kanë udhëtuar nga larg për të marrë pjesë në këtë ceremoni, Zotin Tomë Balbona dhe Pero Vuksanaj nga Nju Jorku gjithashtu vëllezërit Lulash dhe Fran Piniqi nga Brukseli.

Përsëritet skulptorit Skënder Kraja që e realizoi me dashuri këtë vepër.

Përsëritet shumë miqësore për vëllezërit tonë nga Kosova, nga Mali i Zi, Mirdita, Malësia e Madhe, Nikaj Mërturi, etj. që na nderuan me pjesëmarrjen e tyre.

Përsëritet gjithë atyre të ftuarve dhe dashamirëve që kishin dëshirë që të merrnin pjesë në këto ceremoni, por që nuk patën mundësi që të vinin.

Përsëritet e veçantë Pecajve të Shalës, tokës, truallit, ku u lind Mehmet Shpendin, dhe së bashku me Shalën, Dukagjinin dhe Shqipërinë e mbështetën, e rritën dhe e burruan.

Me përlujt dhe shumë respekt, edhe një herë, ju themi të gjithëve mirësardhët dhe shumë faleminderit.

Luigj SHYTI,  
16 korrik 2015



me miq e shokë ja dolëm. Kjo këmbëngulje, kjo vendosmëri, ky bashkëpunim dhe kjo mbështetje e gjerë, bëri të mundur që sot të jemi këtu, nën "hijen" e shtatores së atdhetarit Mehmet Shpendi.

Të dashur pjesëmarrës!

Të afërmit e Mehmet Shpendit, Shoqata "Atdhetare Dukagjini", mbarë Dukagjini, mbarë Shkodra, sot, kanë dy gëzime. Mehmet Shpendi ka hyrë në histori me veprën dhe gjakun e tij prej 100 vjetësh, por sot po vendoset në piedestalin historik që meriton. Në nder dhe respekt të tij dhe gjithë malësorëve dukagjinast e më gjerë, Presidenti i Republikës i ka bërë një nga dhuratat më të çmuara që mund të jenë në një rast të tillë, dhuratë që e vendosë Mehmet Shpendin në altarin e Kombit Shqiptar, si vlerësim i veprës së pavdekshme të tij.

Me këtë rast, të dashur miq, Ju uroj mirëseardhjen dhe Ju përsëritet me shumë respekt, në emër të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare Dukagjini.

Faleminderit që na nderuat me pjesëmarrjen tuaj!

Përsëritet për Presidentin e Republikës, Zotin Bujar Nishani, për vëmendjen, respektin dhe vlerësimin e treguar ndaj

### REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay Produzione Giacche

